



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

P.A.nr.18/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Delushe Halimi kryetare, Lumni Sallauka dhe Franciska Zhitija-Ymeri, anëtar, me bashkëpunëtorin profesionale Zanë Buçinca, në çështjen juridike të konfliktit administrativ sipas padisë së paditëses: Oda Ekonomike e Kosovës (OEK), me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga Lulzim Rafuna dhe Zyra e Avokatisë “E2H & Partners Studio Legale” Sh.p.k., me avokat Ekrem Hoxha, me seli në Prishtinë, Rugën “Rexhep Luci”, Hyrja -I-, Nr. 5, kundër të paditurës: Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), me seli në Prishtinë, Rruga “Bekim Fehmiu”, ish-ndërtesa e Fazitës, Kati -II-, të cilën e përfaqëson Ymridin Misini dhe Gani Buçaj, sipas autorizimit, me bazë juridike: shfuqizimin e pjesshëm të aktit nënligjor normativ të paditurës - nenit 8 të Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike, të datës 18 janar 2017 dhe nenit 2 të Udhëzuesit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë, i ndryshuar dhe plotësuar më datë 13 qershor 2018, si dhe i ndryshuar dhe plotësuar më datë 30 tetor 2018, i miratuar më datë 28 mars 2019, Aktit të Njoftimit Publik për Liberalizimin e Tregut të Energjisë në Kosovë, publikuar më datë 12.03.2025, si dhe detyrimin e ZRRE-së për udhëzimin e KESCO-së, si furnizues i shërbimit universal për korrigjimin e faturave të muajit qershor të shpërndara gjatë muajit korrik 2025, si dhe shfuqizimin e të gjitha kontratave individuale për konsumatorët jo-familjar pas datës 1 qershor 2025, deri në nxjerrjen e bazës së re ligjore dhe rregullatore, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor publik, në praninë e palëve ndërgjyqëse, më datë 05.11.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Aprovohet e themeltë kërkesëpadia e paditëses: Oda Ekonomike e Kosovës (OEK), me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër të paditurës: Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), me seli në Prishtinë, Rruga “Bekim Fehmiu”, ish-ndërtesa e Fazitës, Kati -II-.
- II. Shpallet i paligjshëm dhe shfuqizohet neni 8 i Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike, të datës 18 janar 2017.



- III. Shpallet i paligjshëm dhe shfuqizohet, neni 2 i Udhëzuesit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë, i ndryshuar dhe plotësuar më datë 13 qershor 2018, si dhe i ndryshuar dhe plotësuar më datë 30 tetor 2018, i miratuar më datë 28 mars 2019.
- IV. Hedhet poshtë kërkesëpadia e paditëses në pikën III të petitumit kërkesëpadiësë, në pjesën me të cilën ka kërkuar shfuqizimin dhe shpalljen e paligjshmërisë së Aktit të Njoftimit publik për Liberalizimin e Tregut të Energjisë në Kosovë, të publikuar më datë 12.03.2025, nga e paditura: Zyra e Rregullatorit për Energji, si dhe në pikën -IV- të petitumit të kërkesëpadiësë, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të detyrojë të paditurën, për udhëzimin e KESCO-së, si furnizues i shërbimit universal për korrigjimin e faturave të muajit qershor të shpërndara gjatë muajit korrik 2025, si dhe shfuqizimin e të gjitha kontratave individuale për konsumatorët jo-familjar pas datës 1 qershor 2025, deri në nxjerrjen e bazës së re ligjore dhe rregullatorë, si e palejueshme.
- V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.
- VI. Ky aktgjykim merr formën e prerë menjëherë pas komunikimit të përmbajtjes dhe arsyetimit të tij palëve, dhe DETYROHET e paditura Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), me seli në Prishtinë, që të njëjtin ta publikojë në mënyrë të njëjtë sikurse të miratimit të aktit nënligjore normativ.

A r s y e t i m

I. *Historiku procedural dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse*

Paditësja: Oda Ekonomike e Kosovës (OEK), me seli më Prishtinë, në Gjykatën Supreme të Kosovës, më datë 19.08.2025, ka parashtruar padi për shfuqizimin e pjesshëm të aktit nënligjor normativ të paditurës, përkatësisht nenit 8 të Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike, i datës 18.01.2017 dhe nenit 2 të Udhëzuesit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë, i ndryshuar dhe plotësuar më datë 13 qershor 2018, si dhe si dhe i ndryshuar dhe plotësuar më datë 30 tetor 2018, i miratuar më datë 28 mars 2019, si dhe akti i njoftimit publik i ZRRE-së për liberalizimin e tregut të energjisë në Kosovë, i publikuar më datë 12.03.2025, si dhe



obligimin e të paditurës që të Udhëzoj Kesco-n si furnizues i shërbimit universal që të korrigjoj faturat e muajit qershor të shpërndara gjatë muajit korrik 2025 si dhe të shfuqizoj të gjitha kontratat individuale të lidhura me konsumatorët jo-familjar pas datës 1 qershor 2025 deri në nxjerrjen e bazës së re ligjore dhe rregullatore nga e paditura. Padisë i ka bashkëngjitur kërkesën për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit për pezullimin në tërësi dhe ndalimin e përkohshëm të implementimit të kushteve të vendosura sipas aktit të njoftimit publik të datës 12.03.2025.

I autorizuari i paditësve, me padi, përgjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka kërkuar nga Gjykata Supreme, që të shpall të paligjishëm dhe të shfuqizoj: dispozitat e lartcekura të akteve nënligjore normative. Paditësja pretendon se baza e krijimit të kundërtënëve ligjore fillimisht buron nga neni 3 - Përkufizimet, ku përmes paragrafit 1.26 të Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, është përcaktuar dhe kuptuar termi kyç për objektin e kësaj padie, ku citon: *“Konsumator jofamiljar - person fizik apo juridik që blen energji elektrike të cilën nuk e shfrytëzon për nevoja të veta familjare, e ku përfshihen edhe prodhuesit dhe blerësit me shumicë.”* Fillimisht ky term ka krijuar hendek ligjor dhe hapësirë manipuluese për veprimet e mëtejshme të kryera nga e Paditura, pasi ndarjen mes konsumatorit familjar dhe jofamiljar e ndërlidh me destinimin/përcaktimin e kriterëve, gjegjësisht kategorizimin sipas paragrafit 2 të nenit 37 të Ligjit Nr. 05/L-085 dhe jo siç do duhej në realitet - pra mbi bazën e vëllimit të konsumit të energjisë, duke vendosur pragje (nivele) ndarjeje të qartë mbi bazën e destinimit dhe vëllimit të konsumit për nevoja komerciale. Në praktikë ky term ka shkaktuar efekte dhe dëme joproporcionale, pasi që për shembull: Një biznes i cili operon në fushën e shërbimeve, pra jo konsumator i madh i energjisë elektrike, por me numër të madh të punonjësve, detyrimisht sipas interpretimit të këtij termi dhe kriterëve siç janë përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 37 të Ligjit Nr. 05/L-085 dhe tutje me aktet normative administrative, prapë në mënyrë paushalle dhe pa ndonjë bazë të mirëfilltë - qoftë logjike, por assesi as ekonomike - KESCO është udhëzuar, gjegjësisht detyruar nga ZRRE, dhe më pas KESCO ka lidhur kontrata për furnizim me çmime prej së paku mbi 200% të çmimit të faturës së fundit (atë të muajit maj 2025).

Ka shtuar se: Përmes paragrafit 2 të nenit 37 të Ligjit Nr. 05/L-085, ZRRE ka përcaktuar kriterin ndarës dhe kualifikues për ndarjen (kategorizimin) e konsumatorëve fundorë në dy (2) kategori: konsumator familjar dhe konsumator jofamiljar. *“Të drejtën e furnizimit si shërbim universal e gëzojnë të gjithë konsumatorët familjarë dhe jofamiljarë që kanë qarkullim vjetor*



jo më shumë se dhjetë (10) milionë euro, ose jo më shumë se pesëdhjetë (50) punonjës." E Paditura, përmes njoftimit me karakter obligativ dhe detyrues, dhe më pas KESCO, ka bërë interpretim të njëanshëm dhe të gabuar të kriterëve, edhe ashtu diskriminuese dhe joproporcionale nga aspekti i së drejtës materiale - ligjeve dhe rregullativës që e rregullon sektorin e energjisë elektrike. Arsyet pse këto kritere janë joproporcionale dhe të interpretuara gabimisht me qëllim për të realizuar përfitime ekonomike edhe më të mëdha nga KESCO si biznes privat dhe operatorët e tjerë privatë të licencuar për furnizim me energji elektrike, si pjesë e objektivit ligjor dhe madhor të të paditurës për liberalizimin e tregut i rendit si në vijim:

a) Në leximin e drejtë dhe të duhur të paragrafit 2 të nenit 37 të Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, të gjithë konsumatorët që përmbushin njërin nga kriteret e përcaktuara kanë të drejtë ligjore për furnizim si shërbim universal. Do duhej të lexohej si vijon: Konsumatorë familjarë ose jofamiljarë që kanë qarkullim vjetor jo më shumë se 10 milionë euro, ose Konsumatorë që kanë më shumë se 50 punonjës, por qarkullim vjetor nën 10 milionë euro. b) Një lexim i tillë mbetet esencial dhe njëherësh lexim i drejtë dhe proporcional, pasi që, për shembull, nga komuniteti i afektuar - gjithsej rreth 1,300 operatorë (biznese) private sipas kategorizimit të bërë nga KESCO, sipas udhëzimit/detyrimit nga ZRRE - shumica e bizneseve e përmbushin vetëm njërin kriter (mbi 50 punonjës). Por baza e përcaktimit, në një gjendje momentale kur dihet se bizneset kanë të dhëna të ndryshueshme (variabile) të punonjësve, në varësi nga shumë faktorë si sezonet, marrja e porositve të caktuara të punës/kontratave, apo faktorë jashtë kontrollit të tyre, në vetvete paraqet një kriter të paqëndrueshëm dhe fluid. Ndërkohë KESCO/ZRRE mjaftohet me leximin e përkohshëm të statusit të një biznesi privat, duke i bartur atij detyrime joproporcionale me çmime shumë të larta dhe imponuar detyrimin pa mbështetje të mirëfilltë ligjore. c) Një kategorizim më proporcional do të ishte, për shembull, përmbushja kumulative e të dy kriterëve, ose më saktësisht, në interpretim të drejtë të kornizës ligjore, strategjive sektoriale të energjisë dhe akteve nënligjore rregullatore, të përcaktoreshin kriteret mbi bazën e vëllimit (sasisë) së konsumit të energjisë elektrike dhe jo siç është vepruar njëanshëm dhe pa bazë të mirëfilltë ligjore dhe analize gjithëpërfshirëse të konkurrueshmërisë dhe barazisë së konsumatorëve, duke mos pasur ende një konkurrencë të mirëfilltë në përzgjedhje të lirë dhe konkurruese. d) Shkelja tjetër, e cila kërkon edhe hetim penal, konsiston në faktin se si një operator privat si KESCO ka siguruar qasje në të dhënat e një organi të administratës qendrore siç është ATK, për të pasur qasje në të dhënat konfidenciale të tatimpaguesve/operatorëve privatë, të cilët të dhënat e qarkullimit dhe numrit të punonjësve i deklarojnë në sistemin elektronik EDI të ATK, së për nevojat dhe detyrimin ligjor të deklarimeve të rregullta tatimore. e) Udhëzuesi me nenin



8, përdor termin “konsumator komercial” dhe jo termin ligjor “konsumator jofamiljar”, dhe përmes këtij neni përcakton rregullat për derregullimin e çmimeve për konsumatorët komercialë. Sidoqoftë, e Paditura, sikurse edhe në njoftimin e datës 12.03.2025, sqaron se derregullimi (liberalizimi) i tregut është shtyrë për shkak të pasojave të pandemisë COVID si dhe krizës energjetike. Sipas Udhëzuesit të ndryshuar dhe plotësuar ZRRE përcakton tutje disa kriteret, për shembull ato të tensionit 35 kV dhe 10 kV, por nuk elaboron dhe saktëson qartazi kualifikueshmërinë për kategorizimet e bëra njëanshëm për kriteret bazë: niveli i qarkullimit dhe numri i punonjësve.

Tutje, ka shtuar se: në vazhden e interpretimeve të pabazuara dhe joligjore, ZRRE me rastin e nxjerrjes së Njoftimit me karakter detyrues për palët e afektuara, ka kryer shkelje esenciale të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA), pasi e njëjta nuk ka publikuar asnjë vendim apo akt tjetër administrativ lidhur me vendosjen për të obliguar konsumatorët jofamiljarë që të dalin në treg të lirë. Kujtojmë se nevoja për shfuqizimin e plotë të Njoftimit kërkohet mbi bazën se, edhe pse ky dokument (akt publik) i të paditurës ka prodhuar pasoja për të gjithë konsumatorët jofamiljarë, është në kundërshtim me kriteret e përcaktuara ligjore siç janë elaboruar më lart. g) Se sa i nxituar, pa u bazuar në ndonjë detyrim ligjor apo kontraktual në raport me proceset integruese me tregjet energjetike ndërkombëtare dhe në veçanti me *acquis communautaire*, mjafton t'i referohemi nenit 1, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-085, i cili shprehimisht përcakton se: “Ky Ligj është pjesërisht në përputhje me Direktivën Nr. 2009/72/EC, lidhur me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike dhe Rregulloren Nr. 714/2009/EC, për kushtet për qasje në rrjetin për shërbimet ndërkufitare të energjisë elektrike.” h) Pra, përkundër që ZRRE nuk ka pasur ndonjë detyrim, e njëjta, pa i konsideruar opsionet në dispozicion, i ekspozon konsumatorët jo-familjarë - pra 1,294 biznese private - të përballen pa asnjë përgatitje të domosdoshme, qoftë organizative apo financiare, pa mbështetje financiare nga Qeveria, për të përballuar vetë barrën e papërballueshme financiare nga ngritja jo-proporcionale e çmimit të faturës, që në rastin më të mirë ka efekt rritës prej 200% mbi çmimin paraprak për kilovat të energjisë së konsumuar, si dhe me kërkesa joligjore e imponuese nga KESCO për marrjen e një depozite në lartësinë e së paku 3 faturave të muajve paraprak, deri në 100% të vlerës së konsumit vjetor - pra pagesë avans për shërbimin e papranuar. Kujtojmë gjithashtu se vetë ZRRE, në rastin e energjisë së konsumuar nga konsumatorët familjarë apo jo-familjarë nga katër komunat e veriut të Kosovës, i ka përllogaritur ndër vite në faturat e konsumatorëve familjarë dhe jo-



familjarë në nivel vendi, duke shkaktuar diskriminim, deri vonë, në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese.

Po ashtu, përmes mos konsiderimit të një faze tranzitore për konsumatorët komercialë - gjegjësisht fillimin e liberalizimit të tregut - përveç përmbushjes së një detyrimi ligjor për licencimin e më shumë furnizuesve privatë, kjo nuk ka ndikuar në krijimin e një oferte konkurruese në treg, pasi që të gjithë pa përjashtim ofrojnë çmime së paku 200% më të larta se çmimi për konsumatorët familjarë. Kjo në vetvete paraqet diskriminim dhe joproporcionalitet, pasi që të gjithë këta furnizues furnizohen në masën më të madhe nga KEK-u si prodhuesi i vetëm i energjisë në vendin tonë, por edhe në rastet e importeve të energjisë, të gjithë pa përjashtim furnizohen nga të njëjtat tregje furnizimi, ku çmimet në rajon janë shumëfish më të lira sesa ato të ofruara nga KESCO apo furnizuesit e tjerë të licencuar gjatë viteve 2024-2025 nga ZRRE. BE, lidhur me procesin e liberalizimit të tregut, ndër të tjera, potencon dhe rikujton ZRRE-në se duhet të përkujdeset që procesin e liberalizimit ta kryejë duke siguruar dhe ofruar dobi domethënëse. Tregjet e liberalizuara dhe të ndërlidhura rrisin sigurinë energjetike dhe parashikueshmërinë tregtare. Kjo mundëson integrimin e energjisë së re të ripërtëritshme dhe nxit përmirësimin e efikasitetit të rrjetit, që në fund çon në zvogëlimin e çmimeve për konsumatorët dhe bizneset.

Në referim se sa të nxituara dhe joproporcionale janë masat e ndërmarra, ka theksuar se: informacioni që është i disponueshëm në domenin publik, lidhur me faktin se me qindra padi individuale pranë gjykatave të rregullta janë parashtruar, dhe në disa raste gjykatat kompetente kanë aprovuar masën siguroese, ndërsa ende nuk kanë filluar me shqyrtimet gjyqësore. Për çudi, ZRRE, e bazuar në një aktgjykim të vetëm të shkallës së dytë, ka nxjerrë njoftimin gjegjësisht urdhrin ndaj KESCO-s që të fillojë me ç'kyçjen dhe ndërprerjen e furnizimit me energji ndaj konsumatorëve jo-familjarë që nuk kanë nënshkruar kontratat e reja të furnizimit me KESCO apo ndonjë operator tjetër të licencuar nga ZRRE. Në referim të paligjshmërisë së akteve normative të goditura me këtë padi, e që burojnë nga neni 3 paragrafi 1.26 dhe në veçanti neni 37 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-085, kujtojmë se sipas nenit 5 të LPPA-së, një akt administrativ duhet të jetë i ligjshëm, i arsyeshëm dhe i drejtë. Aktet e nxjerra nga organet publike duhet të respektojnë parimin e proporcionalitetit, duke garantuar që masat e ndërmarra të jenë të domosdoshme dhe të përshtatshme për arritjen e qëllimit të synuar, duke mos i imponuar barrë të panevojshme qytetarëve. Në rastin konkret, kriteret e përcaktuara, përveçse janë të pabazuara, janë edhe kundërtënëse dhe si pasojë kanë shkaktuar favorizime për



KESCO-n dhe operatorët privatë të licencuar nga ZRRE si furnizues, duke shkaktuar dëm të pariparueshëm dhe joproporcional tek komuniteti i bizneseve private, të kategorizuar padrejtësisht nga KESCO përmes qasjes së paautorizuar në të dhënat e një organi të administratës qendrore si ATK-ja.

Ky kategorizim joproporcional dhe i pabazuar, ndër të tjera, cenon rëndë barazinë në qasje ndaj një shërbimi vital publik, siç është energjia elektrike, duke krijuar diskriminim dhe shkaktuar kosto të papërballueshme, joproportionale me çmimet e tregut, si dhe duke favorizuar e pasuruar më tej KESCO-n dhe operatorët furnizues të licencuar, me efekte të drejtpërdrejta në rritjen e çmimeve (inflacionin), humbjen e mijëra vendeve të punës dhe tkurrjen e ekonomisë vendore në mënyrë të pariparueshme e të pakthyeshme. Gjithashtu, në përputhje me nenin 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Barazia para Ligjit), garantohen të drejtat e barabarta dhe ndalohet çdo lloj diskriminimi, duke përfshirë këtu qasjen në shërbime publike - shërbimin universal për furnizim të garantuar me energji elektrike. E drejta për qasje të barabartë në shërbime publike është e garantuar jo vetëm nga Kushtetuta, por edhe nga çdo legjislacion ligjor dhe nënligjor, si dhe nga standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Sipas nenit 4 të LPPA-së, organet publike janë të detyruara të veprojnë në pajtim me parimin e ligjshmërisë, që nënkupton se çdo akt administrativ duhet të ketë bazë të qartë dhe të ligjshme në rregullimin e marrëdhënieve juridike.

Meqë e paditura, përfshirë edhe KESCO-n, duke nxjerrë aktet normative si më lart dhe duke ndërmarrë veprimet për jetësimin e tyre në dëm të subjekteve private - bizneseve të kategorizuara si konsumatorë të detyruar për të lidhur kontratë njëanshme me kushte të panegociueshme dhe sipas udhëzimeve të ZRRE-së të datës 16 gusht 2025 - ka kryer shkeljet nga rrjeti elektrik, provohet se e paditura ka përjashtuar përgjegjësinë e saj për sigurimin e qasjes jodiskriminuese në kohë të arsyeshme. Ajo ka vepruar në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë dhe parimin e proporcionalitetit të përcaktuar në nenin 5 të LPPA-së. Në kuptim të parimit të proporcionalitetit, çdo kufizim i të drejtave dhe interesave të palëve duhet të jetë i arsyetuar, i domosdoshëm dhe në proporcion të drejtë me qëllimin që synohet të arrihet. Në të njëjtën mënyrë, në referim të kundërligjshmërisë, dispozitat e Ligjit të cekura, si dhe udhëzimet e nxjerra nga e paditura, përfshirë edhe njoftimin obligativ, janë në kundërshtim me parimet e Kartës Sociale Evropiane, e cila ndër të tjera parasheh mbrojtjen e konsumatorëve dhe kërkon që shërbimet publike të jenë të qasshme, të sigurta dhe të mbështesin të drejtat themelore të qytetarëve në raport me shërbimet që ata marrin.



Ka ritheksuar se, e paditura ka pasur obligim ligjor të bëjë një analizë të konkurrencës reale në sektorin e energjisë elektrike të cilën nuk e ka bërë duke shmangur detyrimin ligjor dhe duke krijuar favore ekonomike për një operator si KESCO dhe disa operator tjerë tregtar për të kamufluar kinse konkurrencën reale në treg, por kjo konkurrencë reale provohet edhe nga të dhënat publike se nuk ekziston fare. Operatorët tjerë të licencuar nuk garantojnë furnizim me energji elektrike dhe në 90 % të rasteve nuk ofrojnë oferta për konsumatorët jo familjarë. Çdo rregullator tjetër qoftë në regjion apo në BE, sipas direktivës 2009/72EC dhe 2019/944 që i referohet standardeve të BE për liberalizmin e tregjeve për rregullatorin kombëtar për të hyrë në një proces të tillë duhet në mënyrë kumulative të përmbushen tri kritere: sigurimi i ekzistimit të konkurrencës efektive, gjë që nuk e ka bërë fare përmes një autoriteti tjetër të pavarur, të mbrojtë konsumatorin fundor, dhe të garantoj qasje të barabartë dhe jo diskriminuese, që përkundër faktit që pretendojnë se ka një konkurrencë efektive një biznes i bënë katër pesë kërkesa ndërsa ata nuk i bëjnë ofertë, ndërsa KESCO si operator privat i detyron të lënë depozitë financiare të papërballueshme dhe ekonomike. Në fund, i autorizuari i paditësës ka precizuar kërkesën e padisë nga pika II dhe III e petitumit të kërkesëpadisë, duke kërkuar nga gjykata që në vend të fjalës: shfuqizohet të jetë fjala: anulohet.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka specifikuar.

Gjykata me aktvendimin e datës 26.08.2025, ka njoftuar të paditurën Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), lidhur me padinë e ushtruar, dhe pretendimet për paligjshmërinë e aktit normativ të kontestuar nga paditësja, si dhe detyrimin për paraqitjen e dosjes së plotë të procedurës administrative dhe të gjitha dokumenteve që kanë të bëjnë me lëndën e çështjes. Gjithashtu, gjykata i ka informuar palët për të drejtat, detyrimet dhe pasojat juridike që lidhen me veprimet procedurale në këtë çështje të konfliktit administrativ, duke u dorëzuar një kopje të padisë, së bashku me provat përkatëse të bashkëngjitura nga paditësja.

Gjykata, pasi ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor më datë 05.11.2025, e ka shqyrtuar këtë konflikt administrativ në pajtim me nenin 58 dhe 59 të Ligji Nr. 08/L-182 Për Konfliktet Administrative, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 3 / 10 Janar 2024, Prishtinë, (tutje: LKA-së), në praninë e të autorizuarit të paditësës dhe të përfaqësuesit të paditurës.



Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës me përgjigje në padi, dhe përgjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor, ka kërkuar nga Gjykata Supreme, që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses për shpalljen e paligjshmërisë dhe shfuqizimit të aktit nënligjor normative ta hedhë poshtë si të palejueshme dhe të pathemeltë në kuptim të nenit 60 par.3 të LKA-së. Në arsyetim të pretendimeve të saj, e paditura thekson se: Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), e mbështetur në Nenin 8 të këtij Udhëzuesi, derregullimin e çmimeve për konsumatorët fundorë e ka filluar që nga viti 2017, ku: Konsumatorët industrialë të kyçur në nivelin e transmetimit 220 kV do t'i nënshtrohen kushteve dhe çmimeve të tregut për furnizim me energji elektrike më së largu deri në datën e lëshimit të këtij Udhëzuesi, të cilët kanë dalë menjëherë në tregun e hapur; Konsumatorët industrialë të kyçur në nivelin e transmetimit 110 kV do t'i nënshtrohen kushteve dhe çmimeve të tregut për furnizim me energji elektrike më së largu deri më 31 mars 2017; edhe këta konsumatorë kanë dalë me sukses në tregun e hapur më 31 mars 2017; Konsumatorët komercialë në nivelet e tensionit 35 kV dhe 10 kV do t'i nënshtrohen kushteve dhe çmimeve të tregut për furnizim me energji elektrike më së largu deri më 31 mars 2018; dhe Konsumatorët komercialë në nivelin e tensionit 0.4 kV do t'i nënshtrohen kushteve dhe çmimeve të tregut për furnizim me energji elektrike pas përpilimit të listës nga ZRRE, e cila do të identifikojë konsumatorët që nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj për furnizim me energji elektrike nga Shërbimi Universal.

Më 13.06.2018, Bordi i ZRRE-së ka miratuar ndryshimet dhe plotësimet e Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë (18.01.2017), me të cilat shtyheshin afatet për disa kategori konsumatorësh. ZRRE, me qëllim të përmbushjes së detyrimeve ligjore, përmes plotësim-ndryshimit të Udhëzuesit, ka miratuar ndryshimin dhe plotësimin e Nenit 8, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, ku: Konsumatorët komercialë në nivelin e tensionit 35 kV dhe 10 kV do t'i nënshtrohen kushteve dhe çmimeve të tregut për furnizim me energji elektrike më së largu deri më 31 mars 2019. ZRRE thekson se ndryshimi dhe plotësimi i Nenit 8, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike, i miratuar më 13.06.2018, është bërë në zbatim të kompetencave ligjore dhe në përputhje me parimet e Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Ligjit për Energjinë Elektrike. Ky ndryshim ka qenë i natyrës procedurale, për shkak të rrethanave objektive të sektorit të energjisë gjatë periudhës 2017-2018, kushteve teknike dhe operative të sektorit të energjisë në Republikën e Kosovës, si dhe gatishmërisë së furnizuesve të rinj për të hyrë në treg. Këto nuk kanë qenë të mjaftueshme për të garantuar konkurrencë efektive dhe furnizim të qëndrueshëm për këtë kategori konsumatorësh. ZRRE, pas vlerësimit të situatës dhe në zbatim



të mbrojtjes së konsumatorëve, për të shmangur rrezikun që konsumatorët komercialë në 35 kV dhe 10 kV të mbeteshin pa furnizim ose të ekspozoheshin ndaj kushteve të padrejta tregu, ka vlerësuar të nevojshme shtyrjen e afatit deri më 31 mars 2019. Kjo është bërë në përputhje me procesin gradual të liberalizimit, siç ishte parashikuar që në Udhëzuesin e miratuar më 18.01.2017, ku liberalizimi duhej të bëhej në mënyrë graduale, duke u përshtatur me realitetin e tregut dhe kapacitetet institucionale. ZRRE ka pasur detyrim ligjor të sigurojë një tranzicion të kontrolluar, në përputhje me praktikat e vendeve të rajonit dhe të BE-së. Ndryshimet dhe plotësimet e Udhëzuesit janë miratuar nga Bordi i ZRRE-së dhe janë publikuar në faqen zyrtare, duke qenë në dispozicion të të gjitha palëve të interesuara, për qëllime transparence dhe mbrojtjeje të ligjshmërisë. Prandaj, shtyrja e afatit për liberalizimin e tregut për këtë kategori konsumatorësh ishte veprim i ligjshëm, proporcional dhe i justifikuar, me qëllim mbrojtjen e interesit të konsumatorëve dhe funksionalizimin e qëndrueshëm të tregut të energjisë.

Më 30.10.2018, Bordi i ZRRE-së ka miratuar sërish ndryshimet dhe plotësimet e Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë (18.01.2017), i ndryshuar më 13 qershor 2018, duke shtyrë afatin për kategorinë e konsumatorëve komercialë 10 kV. ZRRE ka miratuar ndryshimin e Nenit 8, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, ku: Konsumatorët komercialë në nivelin e tensionit 10 kV do t'i nënshtrohen kushteve dhe çmimeve të tregut për furnizim me energji elektrike më së largu deri më 31 mars 2020. Shtyrja e afatit është bërë në mënyrë të ligjshme, të arsyeshme dhe në interes publik, për shkak të sigurimit të konkurrencës efektive në treg, pasi u vlerësua se ende nuk kishte numër të mjaftueshëm furnizuesish alternativë për të garantuar kushte reale konkurrence dhe oferta të favorshme për konsumatorët në nivelin 10 kV. Liberalizimi i tregut është konceptuar si proces i hapjes graduale, në mënyrë që tregu, konsumatorët komercialë dhe furnizuesit të përshtaten me kushtet e reja pa pasoja të papritura.

Më 28.03.2019, Bordi i ZRRE-së, për herë të fundit, miratoi Udhëzuesin për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë, të ndryshuar më 13 qershor 2018 dhe më 30 tetor 2018, ku përfundimisht përcaktoi: Konsumatorët komercialë në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët nuk i plotësojnë kriteret sipas Nenit 37, paragrafi 2 të Ligjit për Energjinë Elektrike, do t'i nënshtrohen kushteve dhe çmimeve të tregut për furnizim me energji elektrike më së largu deri më 31 mars 2020; dhe Konsumatorët komercialë në nivelin e tensionit 10 kV, të cilët nuk i plotësojnë kriteret sipas



Nenit 37, paragrafi 2 të Ligjit për Energjinë Elektrike, do t'i nënshtrohen kushteve dhe çmimeve të tregut për furnizim me energji elektrike më së largu deri më 31 mars 2021.

ZRRE, më 03.04.2019, përmes shkresës zyrtare, ka njoftuar Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (SKE) në lidhje me amendamentin e Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike, duke bërë të ditur se, pas aprovimit të ligjeve primare të sektorit të energjisë në vitin 2016, të cilat janë në harmoni me paketën e tretë të Direktivave Evropiane, ka ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore për të mundësuar liberalizimin e tregut të energjisë elektrike, duke amendamentuar legjislacionin sekondar. Gjithashtu, përmes shkresës së dërguar në SKE, është njoftuar se, përveç hapave të cekur më lart, ZRRE ka ndërmarrë edhe veprime të tjera konkrete për të siguruar hapjen e tregut, duke larguar nga tregu i rregulluar konsumatorët e kyçur në nivelin e tensionit 220 kV dhe 110 kV, ashtu siç është përcaktuar në Udhëzuesin për Liberalizimin e Tregut.

ZRRE ka njoftuar gjithashtu se ka ndërmarrë hapa për të sqaruar dhe sensibilizuar konsumatorët që nuk i plotësojnë kriteret e shërbimit universal për daljen në tregun e parregulluar, si: identifikimi i konsumatorëve që nuk i plotësojnë kriteret për të gëzuar të drejtën e shërbimit universal sipas kërkesave ligjore dhe njoftimi i tyre për afatin dhe mënyrën e daljes në tregun e parregulluar. Për arritjen e këtij objekti, ZRRE ka mbajtur takime me konsumatorët e kësaj kategorie, si dhe me Odat Ekonomike dhe Klubin e Prodhuesve të Kosovës, si palë të interesuara. ZRRE, përmes kësaj shkrese, ka sqaruar Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë se ka pranuar kërkesa të shumta nga konsumatorët, por edhe nga Odat Ekonomike që përfaqësojnë interesat e tyre, për shtyrjen e afatit për liberalizim të tregut të energjisë elektrike. Gjithashtu, ka pranuar një rekomandim nga Komisioni Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rural, i cili po ashtu ka kërkuar të shqyrtohet mundësia e shtyrjes së afatit për liberalizim të tregut. ZRRE ka njoftuar se gjatë analizimit të gjendjes së sektorit të energjisë elektrike ka vërejtur mangësi për realizimin e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, siç janë: mungesa e aktivizimit të furnizuesve me energji elektrike (përveç furnizuesit aktual) dhe pamundësia nga ana e konsumatorëve për të gjetur furnizues. Prandaj, duke u bazuar në këto rrethana, Bordi i ZRRE-së, në seancën e datës 28 mars 2019, ka shqyrtuar kërkesat e palëve të interesuara dhe ka vendosur të amandamentohet Udhëzuesi për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike, respektivisht neni 8, par. 1, nënpar. 1.3 i këtij udhëzuesi. Ky plotësim/ndryshim i udhëzuesit ka të bëjë me



zgjatjen e afatit të kalimit të konsumatorëve të kyçur në nivelin e tensionit 35 kV dhe 10 kV edhe për një vit.

Konsumatorët e kyçur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët është dashur të dalin në treg të parregulluar më datë 1 prill 2019, sipas amandamentimit të udhëzuesit, iu shtyhet afati deri më 31 mars 2020; ndërsa konsumatorëve të kyçur në nivelin e tensionit 10 kV, të cilët është dashur të dalin në treg të parregulluar më datë 1 prill 2020, iu shtyhet afati deri më 31 mars 2021. ZRRE ka informuar Sekretariatit se vendosja e amandamentimit të Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike është bazuar në analizën e rrethanave aktuale në sektorin e energjisë dhe kërkesave të palëve të interesuara për shtyrje të afatit. Me këtë aprovim, ZRRE e ka parë të arsyeshme që të bëjë shtyrjen e afatit të liberalizimit të tregut dhe, përmes kësaj, të krijojë hapësirë që konsumatorët të përgatiten më mirë për dalje në treg me tarifa të parregulluara, përfshirë edhe gjetjen e furnizuesve të rinj. ZRRE, në fund të shkresës, ka vlerësuar bashkëpunimin me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë (SKE) dhe është e vetëdijshme për kërkesat ligjore që burojnë nga Direktiva Evropiane për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike. Ajo është e përkushtuar që të krijojë hapësirë të përshtatshme për implementimin e tyre.

Lidhur me pretendimet e palës paditëse ka theksuar se: Pretendimet e palës paditëse janë të pabazuara dhe jo të drejta, të cilat i kundërshtojmë në mënyrë të strukturuar në tërësinë e tyre, duke ofruar argumente ligjore dhe prova mbështetëse se pretendimet e tilla nuk janë të bazuara, siç vijon: Pretendimi se Neni 8 (deregullimi i çmimit) është i paligjshëm dhe ka shkaktuar diskriminim ndaj bizneseve, duke i detyruar të dalin në treg të lirë me çmime 200% më të larta, nuk qëndron, pasi që ZRRE konsideron se kjo dispozitë ligjore ka qenë normë kalimtare me afat të përcaktuar deri më 2021. Sot është i paefektshëm juridikisht dhe nuk mund të prodhojë pasojë. Për më tepër, deregullimi i çmimeve është detyrim i Ligjit Nr. 05/L-085 (Neni 3 par. 1.72 lidhur me Nenin 37, par. 2) dhe i *acquis communautaire* të BE-së, jo një masë arbitrare e ZRRE. Pretendimi se ndryshimet e Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike në vitin 2019, që parashihnin kalimin e konsumatorëve 35 kV dhe 10 kV në treg, janë të paligjshme dhe të imponuara, nuk qëndron, për faktin se kjo dispozitë ligjore vetëm ka shtyrë afatet për konsumatorët komercialë dhe ishte në favor të tyre, duke u dhënë më shumë kohë për t'u përshtatur dhe përgatitur. Për më tepër, edhe ky nen është plotësisht i zbatuar dhe i konsumuar juridikisht pas datës 31.03.2021 dhe nuk prodhon më pasojë juridike.



Në çdo rast, ZRRE ka vepruar në kompetencë ligjore sipas Neneve 9, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë.

Pretendimi se Njoftimi Publik i datës 12 mars 2025 është akt administrativ me efekt detyrues, i pabazë ligjore dhe ka detyruar 1.294 biznese të lidhin kontrata me KESCO, nuk qëndron, për faktin se njoftimi nuk është akt normativ, por informues i zbatimit të ligjit ekzistues (Neni 3 par. 1.72 dhe Neni 37 i Ligjit për Energjinë Elektrike). Ai thjesht i njofton konsumatorët për përfundimin e periudhës tranzitore të liberalizimit. Nuk krijon të drejta apo detyra të reja jashtë ligjit. Prandaj, nuk mund të cilësohet si akt administrativ me efekt detyrues në kuptimin e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA). Për më tepër, se Njoftimi i lartcekur nuk është akt nënligjor normativ, e ka vërtetuar edhe Gjykata Supreme e Kosovës në Aktvendimin P.A.nr.18/2025 të datës 26.08.2025, si në vijim: *“Pasi gjykata vlerësoi se akti i kontestuar nuk përmban elementet e një akti ligjor normativ dhe si rrjedhojë nuk janë plotësuar kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për shqyrtim të mëtejshëm të aktit të kontestuar nga paditësja pranë kësaj gjykate, siç përcaktohet në Nenin 59 par. 6 të LKA, si dhe duke pasur parasysh mosplotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të veçanta procedurale, kërkesa hidhet poshtë si e palejuar, në përputhje me dispozitat ligjore që e rregullojnë lejueshmërinë e kërkesave në konflikt administrativ.”*

Pretendimi se kontratat e lidhura nga KESCO me konsumatorët jo-familjarë pas 1 qershorit 2025 janë të pavlefshme dhe imponuese nuk qëndron, për faktin se këto kontrata janë derivat i drejtpërdrejtë i Ligjit Nr. 05/L-085, i cili përcakton qartë kategoritë që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal. ZRRE ka vetëm rol rregullator dhe mbikëqyrës. Kontratat nuk janë të pavlefshme, pasi janë marrëdhënie civile-tregtare mes konsumatorit dhe furnizuesit, në përputhje me dispozitat ligjore. Për më tepër, ZRRE nuk ka detyruar konsumatorët të lidhin kontrata, por ka përcaktuar furnizuesin e shërbimit universal (KESCO) sipas Vendimit V_1925_2024, në përputhje me ligjin.

Pretendimi se liberalizimi i tregut të energjisë ka shkaktuar diskriminim, pasi bizneset paguajnë më shumë se konsumatorët familjarë; kriteret (10 milion € qarkullim vjetor ose 50 punëtorë) janë joproporcionale dhe të interpretuara gabimisht, nuk qëndrojnë, për faktin se kriteret ligjore nuk janë krijuar nga ZRRE, por janë të përcaktuara drejtpërdrejt në ligj (Neni 3, par. 1.72 dhe Neni 37 i Ligjit 05/L-085), të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. ZRRE nuk ka kompetencë t'i ndryshojë ose t'i interpretojë ndryshe. Për më tepër, diferencimi



midis familjarëve dhe jofamiljarëve është standard në BE dhe pjesë e Direktivës 2009/72/EC, e cila është e transpozuar në legjislacionin vendor. Pretendimi se kriteret janë interpretuar gabimisht nuk qëndron, pasi edhe një kriter i vetëm i tejkaluar (p.sh. mbi 50 punëtorë ose 10 milion € qarkullim vjetor) mjafton për përjashtim nga shërbimi universal. Ky është leximi i saktë i ligjit. Duhet shtuar se edhe në shkresat e SKE të datës 02 prill 2025, 03 shtator 2025 dhe 09 shtator 2025, theksohet qartë se kush e gëzon të drejtën e shërbimit universal sipas Direktivave Evropiane, të cilat janë transpozuar në legjislacionin tonë primar të sektorit të energjisë.

Sa i përket pretendimit se bizneset anëtare të paditësit, përkundër se plotësojnë kriteret për të vazhduar të furnizohen nga furnizuesi i shërbimit universal, janë detyruar të kalojnë në treg të hapur, nuk qëndron, pasi që ky pretendim bie ndesh me dispozitat e Nenit 3 par. 1.72 dhe Nenit 37 të Ligjit për Energjinë Elektrike, i cili përcakton qartë kufijtë e të drejtës për shërbim universal vetëm për konsumatorët jofamiljarë (ndërmarrjet e vogla) që punësojnë më pak se 50 punëtorë dhe kanë një qarkullim vjetor më të ulët se 10 milionë euro. Nëse paditësit i plotësojnë vetëm njërin nga dy kushtet, nuk e gëzojnë të drejtën për furnizim nga shërbimi universal. Kalimi i tyre në treg të hapur nuk është imponim, por zbatim i drejtë i ligjit.

Pretendimi se ZRRE ka interpretuar gabimisht kriterin “10 milion € qarkullim ose 50 punëtorë”, duke e aplikuar njëanshëm, nuk qëndron, për faktin se neni 3, par. 1.72 lidhur me nenin 37, par. 2 të Ligjit është i qartë: të drejtën e shërbimit universal e kanë vetëm ata konsumatorë familjarë dhe ndërmarrjet ekonomike që punësojnë jo më shumë se pesëdhjetë (50) punonjës dhe që kanë qarkullim vjetor jo më shumë se dhjetë (10) milionë euro për t’u furnizuar me energji elektrike të një kualiteti të caktuar, me çmim të arsyeshëm, qartësisht të krahasueshëm, transparent dhe jodiskriminues. Ky interpretim është konfirmuar edhe nga praktika rregullative dhe është i harmonizuar me acquis të BE-së. ZRRE nuk ka kompetencë të ndryshojë ose të japë një interpretim tjetër përmbajtësor të ligjit. Siç u theksua edhe më lart, edhe në shkresat e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë të datës 02 prill 2025, 03 shtator 2025 dhe 09 shtator 2025, potencohet qartë se cilët konsumatorë gëzojnë të drejtën e shërbimit universal; pra, në shkresa janë të përshkruara edhe kriteret e shërbimit universal dhe të cilat janë edhe në Direktivat Evropiane 2009/72 dhe 2019/944.

Pretendimi se përdorimi i termit “konsumator komercial” nuk është ligjor, pasi ligji përdor “konsumator jofamiljar”, nuk qëndron, për faktin se termi “konsumator jofamiljar” është



vetëm një përdorim praktik/teknik për të dalluar konsumatorët/ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari ekonomike. Ai është në përputhje me përkufizimin e nenit 3.1.26 të Ligjit Nr. 05/L-085. Nuk ka krijuar paqartësi juridike, pasi është i njëjtë në përmbajtje me termin “jofamiljar”. Gjithashtu, informojmë gjykatën se sipas Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike përdoret termi “konsumator jofamiljar” dhe sipas nenit 3, paragrafi 1.26, konsumator jofamiljar nënkupton person fizik apo juridik që blen energji elektrike të cilën nuk e shfrytëzon për nevoja të veta familjare, e ku përfshihen edhe prodhuesit dhe blerësit me shumicë, dhe se në asnjë dispozitë ligjore nuk përmendet kategorizimi i konsumatorëve sipas vëllimit të konsumit.

Pretendimi se liberalizimi është i parakohshëm pasi furnizuesit ofrojnë çmime më të larta nuk qëndron, për faktin se liberalizimi i tregut të energjisë elektrike nuk varet nga perceptimi i çmimeve, por është detyrim ligjor dhe ndërkombëtar sipas Ligjit Nr. 05/L-085 dhe Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Çmimet reflektojnë kushte tregu (kostot e importit, bursës rajonale, etj.) dhe nuk përcaktohen nga ZRRE. Liberalizimi i tregut të energjisë ka qenë gradual dhe në faza, me periudha tranzitore deri më 2021, duke respektuar proporcionalitetin. Pretendimi se KESCO ka marrë të dhëna nga akt pa bazë ligjore është jo i saktë, pasi verifikimi i kriterëve (qarkullim dhe numër punëtorësh) është detyrim ligjor sipas nenit 37 të Ligjit për Energjinë Elektrike. Ky verifikim bëhet përmes dokumenteve që konsumatori vetë i paraqet tek furnizuesit. Nëse KESCO ka përdorur mjete të tjera teknike, kjo nuk është vendim i ZRRE dhe nuk e bën të paligjshëm procesin e liberalizimit, pasi KESCO ka të vendosur obligimin e detyrimit publik dhe i nënshtrohet legjislacionit të Republikës së Kosovës, pasi është i rregulluar.

Pretendimi se bizneset paguajnë më shumë dhe subvencionojnë konsumatorët e veriut fare nuk është i vërtetë dhe nuk qëndron, për faktin se që nga viti 2022 pjesa veriore furnizohet me furnizues privat të licencuar nga ZRRE, i cili është i bazuar në marrëveshjet e Brukselit, dhe ata konsumatorë nuk i nënshtrohen rregullimit të tarifave, por furnizohen me çmime tregu. Çështja e mbulimit të humbjeve në veri para vitit 2017 është trajtuar me masa të veçanta dhe tashmë është objekt i vendimeve të veçanta të ZRRE dhe Gjykatës Kushtetuese, jo e lidhur me liberalizimin e tregut të energjisë. Gjithashtu duhet sqaruar se nga viti 2017 e tutje, kostot e pjesës së katër komunave në veri të Republikës së Kosovës nuk janë pjesë e kostove të konsumatorëve të tjerë. Andaj, edhe njëherë e informojmë gjykatën e nderuar se çmimet e



energjisë elektrike për konsumatorët jofamiljarë janë rezultat i kushteve të tregut dhe jo vendim arbitrar i ZRRE.

Pretendimi se liberalizimi ka shkaktuar dëm ekonomik për bizneset nuk qëndron, për faktin se liberalizimi është proces i pashmangshëm për të integruar Republikën e Kosovës në tregun rajonal dhe evropian të energjisë. Efektet e tregut nuk përbëjnë shkelje ligjore nga ZRRE. Përkundrazi, tregu konkurrues pritet të sjellë efikasitet dhe oferta më të lira afatgjata. ZRRE ka përmbushur detyrimet ligjore të përcaktuara në ligjet primare të sektorit të energjisë dhe nuk është përgjegjëse për politikën makroekonomike. ZRRE informon Gjykatën Supreme se, në kuadër të zbatimit të detyrimeve të Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe me qëllim të krijimit dhe funksionimit të një tregu konkurrues të energjisë elektrike, Shqipëria dhe Kosova kanë themeluar Bursën Shqiptare të Energjisë - ALPEX, e cila ka filluar operimin si bashkim i tregut Kosovë - Shqipëri. Informojmë Gjykatën se ALPEX-i është një platformë transparente për tregtimin e energjisë, e cila, përveç ngritjes së konkurrencës në çmimet me pakicë, krijon edhe mundësi për investime të reja të sektorit privat në kapacitetet gjeneruese nga burimet e ripërtëritshme të energjisë (BRE), si dhe qasje më të lehtë për furnizuesit e rinj. Pra, ZRRE, në bashkëpunim edhe me Rregullatorin e Shqipërisë, kanë harmonizuar tërë legjislacionin e nevojshëm për krijimin e kësaj burse dhe bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike. Tanimë Bursa Shqiptare ALPEX është funksionale dhe ofron mundësi shumë të mira për të gjithë aktorët e sektorit të energjisë. Në vazhden e krijimit të kushteve sa më të favorshme për një treg sa më funksional, ZRRE ka nënshkruar Memorandume Mirëkuptimi me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut për njohjen reciproke të licencave për furnizim me energji elektrike dhe tregtim, dhe kjo ka rritur edhe më shumë konkurrencën, ku aktualisht në Kosovë kemi të licencuar 28 furnizues të energjisë elektrike, dhe se vetëm për këta 4 muaj, 6 furnizues të energjisë elektrike janë aktivë dhe kanë dhënë oferta konsumatorëve, gjë që tregon qartë se ka treg të energjisë elektrike dhe ka oferta nga furnizuesit.

Pretendimi se ZRRE, me datë 16.08.2025, në formë të dhunshme, me shoqërim të Policisë së Kosovës, ka shkëputur konsumatorët komercialë të cilët nuk kanë nënshkruar kontratë furnizimi me KESCO, nuk qëndron, madje është tendencioz, pasi ZRRE nuk ka marrë vendim për shkëputjen e këtyre konsumatorëve dhe nuk ka detyruar asnjë konsumator të nënshkruajë me KESCO. Në vijim do të paraqesim argumentet se kjo nuk qëndron: të gjithë konsumatorët jofamiljarë, të cilët nuk kanë nënshkruar kontratë komerciale me njërin nga furnizuesit e licencuar, janë furnizuar me energji elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për 60



ditë. Neni 37, paragrafi 7 i Ligjit për Energjinë Elektrike e specifikon se: *“Në rast se konsumatori fundor nga nënparagrafi 1.3 i këtij neni, që është furnizuar nga një furnizues i mundësisë së fundit, dështon të hyjë në marrëveshje me furnizuesin e ri brenda periudhës së përcaktuar në paragrafin 6 të këtij neni, operatori i sistemit do ta ndërpresë furnizimin me energji elektrike.”* Pra, Ligji për Energjinë Elektrike e ka paraparë që konsumatorët të cilët janë furnizuar nga një furnizues i mundësisë së fundit dhe pas këtij afati nuk nënshkruajnë marrëveshje me furnizuesin e ri, atëherë operatori i sistemit do ta ndërpresë furnizimin.

Gjithashtu, pretendimi i palës paditëse se i kemi detyruar të nënshkruajnë marrëveshje me KESCO nuk qëndron po ashtu, dhe këtë e dëshmon edhe fakti se, nëse i referohemi shkresës së KOSTT SH.A. nr. 2226 të datës 08.09.2025, shihet qartë se një numër i madh konsumatorësh nuk kanë nënshkruar me KESCO, por me furnizues të tjerë, pra rreth 60% e konsumatorëve tani në treg të lirë janë me furnizues të tjerë e jo me KESCO. Pretendimi se masat bien ndesh me Kushtetutën (barazia para ligjit, neni 24) dhe me Kartën Sociale Evropiane nuk qëndrojnë, për faktin se liberalizimi i tregut është proces i detyrueshëm sipas Marrëveshjes së Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe harmonizohet me *acquis communautaire*. Për informim, Republika e Kosovës është nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe me këtë është e obliguar të përmbushë të gjitha detyrimet që dalin nga Traktati. Pretendimet për shkelje të Kushtetutës apo Kartës Sociale nuk qëndrojnë, pasi legjislacioni i Kosovës është i harmonizuar me standardet ndërkombëtare dhe praktikën e BE-së. ZRRE vlerëson se neni 24 i Kushtetutës (barazia para ligjit) nuk shkelet, pasi të gjithë konsumatorët jofamiljarë (ndërmarrjet ekonomike) trajtohen njësoj sipas ligjit. Karta Sociale Evropiane nuk kërkon që bizneset të subvencionohen me tarifa të rregulluara; ajo lidhet me mbrojtjen e konsumatorëve të cenueshëm (vulnerabël), gjë që ka qenë e adresuar në nenin 9 të Udhëzuesit të vitit 2017. Direktiva 93/13/EC zbatohet për konsumatorë individualë, jo për marrëdhënie kontraktuale ndërmjet bizneseve dhe një furnizuesi të licencuar. Pra, nuk është e aplikueshme në këtë rast.

ZRRE përfundimisht e informon Gjykatën Supreme të Kosovës se Udhëzuesi për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike, i miratuar nga Bordi i ZRRE-së më 18 janar 2017, me plotësimet dhe ndryshimet përkatëse, ka pasur karakter tranzitor dhe funksion udhëzues, duke përcaktuar fazat, kushtet dhe afatet për liberalizimin gradual të tregut të energjisë elektrike në Kosovë. Ky udhëzues ka shërbyer si instrument orientues për zbatimin e dispozitave ligjore, në pajtim me Ligjin për Energjinë Elektrike dhe Ligjin për Rregullatorin



e Energjisë, dhe si i tillë është konsideruar i konsumuar dhe i zbatuar në tërësi pas realizimit të funksioneve të tij. Në përputhje me parimet e jurisprudencës administrative, një akt udhëzues që ka shteruar efektet e tij juridike pas datës 31 mars 2021 nuk mund të jetë më objekt shfuqizimi apo kontestimi, ngase nuk prodhon më pasoja juridike. Ky parim njihet në doktrinën e të drejtës administrative si “parimi i efektit të konsumuar të aktit juridik” (actus consumatus), sipas të cilit një akt që ka arritur dhe përmbushur qëllimin e vet konsiderohet i tejkaluar dhe pa efekt të mëtejshëm detyrues.

Me qëllim të informimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ju njoftojmë se nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës është pranuar njoftimi lidhur me rastin KI 252/25 Nr. ref. 626/25/drlsa të datës 27 gusht 2025, lidhur me kërkesën e parashtruar nga Partia Demokratike e Kosovës, të cilën e përfaqëson avokati Faton Fetahu, ku konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, AA.nr. 718/2025, të datës 04 korrik 2025, me kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme ndaj Aktvendimit AA.nr. 718/2025 dhe A.nr. 2124/25 të datës 04.07.2025, Vendimin e ZRRE për refuzimin e kundërshtimit V_2724_2025 të datës 13.06.2025, dhe ndaj Njoftimit Publik për Liberalizimin e Tregut të Energjisë në Kosovë të datës 12 mars 2025. ZRRE, brenda afatit ligjor të kërkuar nga Gjykata Kushtetuese, ka parashtruar përgjigje duke i paraqitur të gjitha argumentet ligjore se procesi i liberalizimit të tregut ka qenë proces ligjor dhe i përcaktuar me Ligjin për Energjinë Elektrike, me kërkesën që të refuzohet si e pabazuar dhe e paarsyeshme, dhe rrjedhimisht të refuzohet si e papranueshme në tërësinë e saj.

Gjithashtu, ZRRE ka kundërshtuar edhe masën e përkohshme, duke paraqitur argumentet se pezullimi i akteve/vendimeve për të hyrat maksimale të lejuara që lidhen me implementimin e liberalizimit të tregut për konsumatorët komercialë, përveç se do të shkaktoje pasiguri juridike dhe paqartësi ligjore, do të cenonte seriozisht stabilitetin e tregut të energjisë elektrike, duke krijuar pasoja të drejtpërdrejta negative për furnizuesit privat, të cilët kanë lidhur kontrata në mirëbesim me konsumatorët komercialë, do të shkaktoje kosto shtesë të paarsyeshme për operatorët e rregulluar dhe konsumatorët fundorë (familjarë dhe jofamiljarë), të cilët, në rast të kthimit të detyruar tek Furnizuesi me Shërbim Universal, do të përballeshin me obligime financiare që nuk janë detyrime të tyre, si dhe në fund do të dëmtonte interesin publik, ngase do të pengonte procesin e liberalizimit të tregut, që është detyrim ligjor dhe obligim ndërkombëtar i Republikës së Kosovës. ZRRE njofton Gjykatën e nderuar se ky proces është



në shqyrtim pranë Gjykatës Kushtetuese dhe deri në parashtrimin e kësaj përgjigjeje në padi nuk kemi pranuar ndonjë aktgjykim nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.

Në fund thekson se, padia është e pabazuar në ligj dhe në fakte. ZRRE ka vepruar brenda kompetencave të saj ligjore dhe kushtetuese duke zbatuar dispozitat e ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe të Energjisë Elektrike. UA për liberalizimin e tregut dhe ndryshim plotësimet përkatëse kanë pasur efekt tranzitor dhe udhëzues duke përcaktuar fazat, kushtet për liberalizimin gradual të kalimit në liberalizimin e energjisë elektrike. Pra kanë qenë si instrumente udhëzuese dhe në përputhje me legjislacionin primar dhe direktivat e BE-së. Liberalizimi i tregut është detyrim ligjor që buron nga traktatet e energjisë dhe është zbatuar në mënyrë të ligjshme. ZRRE rithekson se asnjë konsumator nuk ka mbetur pa furnizues ngase ZRRE ka caktuar furnizuesin e mundësisë së fundit, duke siguruar mbrojtjen e konsumatorëve dhe stabilitetin e tregut. ZRRE thekson se të gjithë konsumatorët komercial kanë lidhur kontrata me furnizues privat dhe tregu i energjisë elektrike për këtë grup të konsumatorëve është i liberalizuar në përputhje me detyrimet ligjore. Mbi këtë bazë i propozojmë gjykatës që të refuzoj padinë e paditëses si të palejueshme dhe të pathemeltë, në kuptim të nenit 60, par. 3 të Ligjit për Konfliktet Administrative, meqë Udhëzuesi për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike, i miratuar më 18 janar 2017 me ndryshimet dhe plotësimet përkatëse, ka pasur thjesht karakter tranzitor dhe orientues, është zbatuar plotësisht dhe ka shëruar efektet e tij juridike pas datës 31 mars 2021, pasi që, sipas parimit të njohur në jurisprudencën administrative të “efektit të konsumuar të aktit juridik” (actus consumatus), nuk prodhon më pasoja juridike dhe nuk mund të jetë objekt shfuqizimi apo kontestimi gjyqësor.

II. Vlerësimi i gjendjes faktike dhe provat e administruara

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor - publik të datës 05.11.2025, ka administruar provat relevante dhe atë: Udhëzuesi për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike, i datës 18.01.2017, dhe Udhëzuesi për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë, i ndryshuar dhe plotësuar më datë 13 qershor 2018, si dhe i ndryshuar dhe plotësuar më datë 30 tetor 2018, dhe i miratuar më 28 mars 2019; Njoftim Publik mbi Liberalizimin e Tregut të Energjisë në Kosovë, publikuar në faqen zyrtare të ZRRE-së; Vendimi V_1925_2024, i datës 02 prill 2024, për vendosjen e obligimit të shërbimit



publik; Komunikatë, e publikuar në faqen zyrtare të ZRRE-së; Publikimi me titull: Liberalizimi i Tregut të Energjisë: 1,294 kompani të obliguara të zgjedhin vetë furnizuesin nga Qershori 2025, Oda Ekonomike e Kosovës, burimi: ATK; Publikimi: Aplikim për bizneset për Furnizim me KESCO, me tarifa të Rregulluara; Publikimi: BE-ja thotë se nuk përmbushen kushtet, do të ndihmojë tranzicionin drejt tregut të liberalizuar të energjisë me 28.2 milion euro, datë 3 qershor 2025, në portalin: koha.net; Fatura - Invoice F1281, Furnizimi me Energji Elektrike Qershor 2025, e datës 30.07.2025; Fatura 21930462; Shkresa: Amandamenti i Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike, nr.prot.193/19, e datës 03.04.2019; Shkresa në gjuhën angleze me titull: Market Opening and Board of Ero, përkthyer: Hapja e tregut dhe Bordi i ZRRE-së, 29 shtator 2020, Sekretariati i Komunitetit për Energji; Përgjigje në letrën e Sekretariatit të Komunitetit për Energji, nr.prot.313/20, e datës 01.10.2020, lidhur me hapjen e tregut dhe mandatin e anëtarëve të bordit të ZRRE-së; Vendim V_1544_2022, e datës 29 korrik 2022, për caktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit; Vendim V_2762_2025, nr.prot.546/25, e datës 07.07.2025, për caktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit për periudhë prej gjashtë (6) muajsh; Tabela: Licencat për Furnizim me Energji Elektrike në Kosovë të cilat mund të kryejnë edhe aktivitetin e Furnizimit me shumicë (tregtisë) së energjisë elektrike në Kosovë, e datës 05.09.2025; Shkresa: Gjendja e furnizuesve në treg të lirë, nr.prot.2226, datë 08.09.2025 (preliminare), KOSTT; Vendim V_2698_2025, nr.prot.232/25, e datës 23.04.2025, mbi aprovimin e të hyrave të lejuara maksimale për Furnizuesin e Shërbimit Universal (FSHU) për vitin relevant tarifar 2025; Shkresa: nga Zyra e BE-së në Prishtinë - Kosovë, drejtuar Bordit të ZRRE-së, datë 2 prill 2025; Shkresa: Sekretariati për Energji, me titull: ERO's Decision on the Liberalization of the Electricity Market in Kosovo, 4 shtator 2025; Shkresa: Azhurnimet vjetore të të hyrave dhe tarifave për OST/OT, OSSH dhe FSHU, me nr.prot.1425/29, datë 20.12.2024; Shkresa: Aplikim për të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2025, datë 29.01.2025; Publikimi i raportit konsultativ për të hyrat maksimale të lejuara, e datës 14.03.2025; Raport konsultativ - përshtatjet vjetore të të hyrave të lejuara maksimale për FSHU, viti relevant 2025, 14 mars 2025; Raport Përfundimtar - Përshtatjet vjetore të hyrave të lejuara maksimale për FSHU, OSSH dhe OST, përgjigjet ndaj komenteve, 11 prill 2025; Shkresa: Propozim për Tarifat e Furnizuesit me Shërbim Universal për vitin 2025, nr.434/29, e datës 14 prill 2025; Vendim V_2703_2025, e datës 29.04.2025, mbi aprovimin e tarifave me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal, që do të mblidhen nga data 01 maj 2025 deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifar; Parashtresa: Njoftim lidhur me regjistrimin e kërkesës dhe dorëzimin e kopjes së kërkesës në



Gjykatën Kushtetuese të Kosovës nr. KI252/25; Parashtrësit: publikimet në ëeb faqen e ZRRE dhe proceset e shqyrtimeve.

Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 59 paragraf 8 të Ligjit nr.08/L-182 për Konfliktet Administrative, i publikuar në Gazetën Zyrtare më datë 10.01.2024, dhe ka hyrë në fuqi më datë 10.01.2025 (më tutje: LKA), ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit kontestues në drejtim të thënieve në padi, thënieve në seancë dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ.

Nga shkresat e lëndës rezulton se: Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), me seli në Prishtinë, më datë 18 janar 2017, ka nxjerrë aktin nënligjor normativ: Udhëzuesin për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike ndërsa më datë 28 mars 2019 Udhëzuesin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë, i ndryshuar dhe plotësuar më datë 13 qershor 2018, si dhe i ndryshuar dhe plotësuar më datë 30 tetor 2018.

Aktin nënligjor normativ të kontestuar, përkatësisht Udhëzuesin për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike, të datës 18.01.2017, Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji e ka nxjerrë në mbështetje të nenit 9 paragrafin 1, nënparagrafin 1.7, Nenin 15, paragrafi 1, nënparagrafi 1.14, 1.15, paragrafi 7, nënparagrafi 7.1, Nenin 25, Neni 26, Nenin 30, paragrafi 1, 2, nënparagrafi 2.9, Nenin 38, paragrafi 2, Nenin 47, paragrafi 3, nënparagrafi 3.9 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05-L-084); Dispozitat e Nenit 4, Nenit 5, Nenit 12, paragrafi 1, Nenit 14, paragrafi 1, Nenit 15, paragrafi 6, Nenit 18, 19, 22, 23 dhe 24 të Ligjit për Energji (Ligji Nr 05-L-081); Dispozitat e Nenit 5, paragrafi 1, 2, 3, 4, 5, nënparagrafi 5.1, 5.2, 5.3, dhe 5.4, paragrafi 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, Nenit 6, paragrafi 1 dhe 2, Nenit 7, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.11, 1.12, 1.13, paragrafi 3 dhe 4, Nenin 8, paragrafi 1, 3, 4, 7, 8, 9 dhe 10, Nenit 22, 23, paragrafi 1, 2, 6 dhe 8 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05-L-085).

Ndërsa, ndryshim plotësimin e tij e ka nxjerrë në mbështetje të nenit 9 paragrafin 1, nënparagrafin 1.7, Nenin 25, Neni 26, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05-L-084). Qëllimi i këtij Udhëzuesi është ndryshimi dhe plotësimi i Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë të datës 18 janar 2017 dhe plotësim ndryshimet të datës 13 qershor 2018 të miratuara nga Bordi i Rregullatorit.



Pas shqyrtimit të akteve nënligjore normative të kontestuara, Gjykata konstaton se dispozitat e kontestuara bien ndesh me dispozitat ligjore.

III. Dispozitat relevante kushtetuese, ligjore dhe ndërkombëtare

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e publikuar në Gazetën Zyrtare më datë 09.04.2008, dhe ka hyrë në fuqi më 15.06.2008

Neni 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], paragraf 3 përcakton: “Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit”.

Ligji Nr. 08/L-182 për Konfliktet Administrative, Gazeta Zyrtare Nr.3, i miratuar më 14 dhjetor 2023, dhe në fuqi nga data 10 janar 2025, ka përcaktuar:

Neni 3 [Përkufizimet]: “1. Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: 1.1. Akt nënligjor normativ - një akt, i nxjerrë në bazë të autorizimit të shprehur të një ligji të miratuar nga Kuvendi, që përcakton rregulla të detyrueshme sjellje në mënyrë abstrakte dhe të përgjithshme”.

Neni 5 [Parimi i ligjshmërisë]: “Gjykata kompetente shqyrton konfliktin dhe vendos në bazë të Kushtetutës dhe ligjit”.

Neni 10 [Organizimi dhe Kompetenca]: “4. Gjykata Supreme, gjykon revizionin dhe si shkallë e parë dhe e vetme, padinë për shfuqizimin e një akti nën-ligjor normativ”.

Neni 11 [Përbërja në gjykim]: “3. Gjykata Supreme, gjykon lëndën në kolegji të përbërë prej tre (3) gjyqtarësh”.

Neni 13 [Llojet e padive]: “1. Në konfliktin administrativ, paditësi mund të kërkojë: 1.6. shfuqizimin e një akti nënligjor normativ (në tekstin e mëtejme “padia ndaj aktit nënligjor normativ”).

Neni 25 [Padia për shfuqizimin e aktit nënligjor normativ], “1. Me padinë për shfuqizimin e një akti nënligjor normativ, paditësi kërkon deklarimin e paligjshmërisë të një dispozite të një akti nënligjor normativ apo të tërë aktit nënligjor normativ në tërësinë e tij dhe përkatësisht shfuqizimin e tyre. 2. Padia për shfuqizimin e një akti nënligjor normativ mund të ngrihet nëse një person fizik apo juridik pretendon se akti është në kundërshtim me ligjin dhe se për këtë shkak i cenon apo do ti cenojë në të ardhmen, të drejtat apo interesat e tij të ligjshëm. 3. Mbajtësit e interesave kolektive apo mbajtësit e interesave të gjera të publikut, gjithashtu



mund të ngrenë këtë padi nëse pretendojnë se akti është në kundërshtim me ligjin dhe se për këtë shkak ka cenuar apo mund ta cenojë në të ardhmen interesin kolektiv apo përkatësisht atë të gjerë të publikut. 4. Padia mund të ngrihet edhe nga një organ publik i autorizuar shprehimisht me ligj të veçantë dhe për rastet e parashikuara me atë ligj. 5. Në padinë kundër aktit nënligjor normativ, i paditur, është organi publik që ka miratuar aktin. 7. Padia për shfuqizimin e një akti nënligjor normativ paraqitet në çdo kohë për sa akti është në fuqi, madje edhe pas miratimit por para publikimit të detyrueshëm të aktit, për efekt të hyrjes të tij në fuqi”.

Ligji Nr. 05/L-084 Për Rregullatorin e Energjisë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 25 / 14 Korrik 2016, Prishtinë

Neni 1 [Qëllimi], “1. Ky ligj përcakton kompetencat, detyrat dhe funksionet e Zyrës së Rregullatorit për Energji, përfshirë kushtet për dhënien e licencave për kryerjen e aktiviteteve në fushën e energjisë, certifikimin e aktiviteteve të operatorëve të transmetimit në sektorin e energjisë procedurat për dhënien e autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese, krijimin dhe funksionimin efikas të tregjeve konkurruese të energjisë, mbrojtjen e konsumatorit, si dhe kriteret për rregullimin e tarifave dhe kushtet për furnizim me energji.”

Neni 9 [Detyrat kryesore të Bordit të Rregullatorit], “1. Përveç përgjegjësive të përcaktuara me këtë ligj, Bordi i Rregullatorit: 1.7. harton dhe miraton akte nënligjore që janë të nevojshme për zbatimin e këtij ligji.”

Neni 15 [Detyrat dhe përgjegjësitë e Rregullatorit], “1. Për përmbushjen e detyrave, Rregullatori ka autoritetin dhe përgjegjësitë në vijim: 1.2. të përkujdeset për funksionim transparent dhe jodiskriminues të tregjeve të energjisë, duke u bazuar në parimet e tregut të lirë, sa u përket aktiviteteve konkurruese dhe aktiviteteve të rregulluara; 1.11. ta promovojë tregun e brendshëm konkurrues të energjisë, duke siguruar hapje efektive të tregut për të gjithë konsumatorët dhe furnizuesit dhe krijim të kushteve të nevojshme për funksionim efektiv e të qëndrueshëm të rrjeteve të energjisë, duke i marrë parasysh objektivat afatgjata të sektorit, që kanë të bëjnë me autoritetet rregullative të sektorit të energjisë të Palëve Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë”.

Neni 51 [Ngarkimi i obligimit të shërbimit publik], “1. Rregullatori mund të ngarkojë obligime të shërbimit publik mbi secilën ndërmarrje të energjisë, në pajtim me Ligjin për Energjinë Elektrike dhe Ligjin për Gazin Natyror, me anë të vendimeve që Rregullatori gjithashtu të sigurojë aranzhime që sigurojnë që: 1.1. obligimet e shërbimit publik të zbatohen



në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese si dhe të mos pengojnë hapjen e tregjeve të energjisë, siç parashikohet me këtë ligj dhe ligjet tjera në fuqi.”

***Ligji Nr. 05/L - 081 për Energjinë, Gazeta Zyrtare e Republikës Së Kosovës / Nr. 24 / 13
Korrik 2016, Prishtinë***

Neni 3 [Përkufizimet]: “1. Termat e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim: “1.35. Shërbim universal - shërbim i detyrueshëm i furnizimit publik me energji elektrike për t’ua siguruar kategorive të caktuara të konsumatorëve të drejtën të furnizohen me energji elektrike të cilësisë së kërkuar, me tarifa të arsyeshme, lehtë të krahasueshme, transparente, të paanshme dhe jodiskriminuese; 1.59. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (ECS) - institucion që siguron mbështetje administrative për Këshillin Ministror, Grupin e Nivelit të Lartë të Përhershëm, Bordit Rregullator dhe Forumet, në udhëheqjen e procesit të zhvillimit të Komunitetit të Energjisë.”

Neni 20 [Kryerja e veprimtarive energjetike]: “2. Në pajtim me Ligjin për Energjinë Elektrike, disa kategori të konsumatorëve gëzojnë të drejtën e furnizimit universal dhe përfitojnë nga furnizimi i garantuar.”

Ligji Nr. 05/L - 085 për Energjinë Elektrike, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 26 / 21 Korrik 2016, Prishtinë

Neni 3 [Përkufizimet]: “1. Termat e përdorur në këtë ligj kanë këto kuptime:

1.16. Furnizues - ndërmarrjen e energjisë të licencuar për të kryer veprimtarinë e furnizimit;

1.17. Furnizim - shitjen, përfshirë rishitjen e energjisë elektrike të konsumatorët;

1.18. Furnizim i garantuar - furnizimi i përkohshëm i konsumatorit fundor, të cilit, në raste të përcaktuara në këtë ligj, i mundësohet furnizimi i përkohshëm me kufizimet e përcaktuara në këtë ligj;

1.19. Furnizues i mundësisë së fundit - është një furnizues i caktuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji, i cili ofron për një periudhë të kufizuar kohe shërbimin e furnizimit në kushte të rregulluara ndaj konsumatorëve, të cilët nuk kanë mundur të kontraktjnë vetë një furnizues ose kanë humbur furnizuesin e tyre;

1.26. Konsumator fundor - konsumatorin e energjisë elektrike që blenë energjinë elektrike për përdorimin vetanak;



1.28. Konsumator jofamiljar - person fizik a juridik që blen energji elektrike të cilën nuk e shfrytëzon për nevoja të veta familjare, e ku përfshihen edhe prodhuesit dhe blerësit me shumicë;

1.51. Obligime të shërbimit publik - obligim që i imponohet një ndërmarrjeje të energjisë elektrike sipas ligjit ose sipas një vendimi të aprovuar nga Qeveria ose Zyra e Rregullatorit për Energji varësisht nga fushat e përgjegjësisë se tyre mund të vendosin obligime që mund të lidhet me sigurinë e furnizimit me energji elektrike, rregullshmërinë, kualitetin dhe çmimet e furnizimit, efikasitetin e energjisë, energjinë nga burimet e energjisë së ripërtërishme si dhe mbrojtjen mjedisore dhe klimatike, por që nuk krijon diskriminim dhe nuk dëmton konkurrencën përtej masës së domosdoshme për arritjen e qëllimit për të cilin imponohet shërbimi publik në fjalë;

1.72. Shërbimi universal i furnizimit - e drejta e konsumatorëve familjarë dhe ndërmarrjeve ekonomike që punësojnë jo më shumë se pesëdhjetë (50) punonjës dhe që kanë qarkullim vjetor jo më shumë se dhjetë (10) milion euro që të furnizohen me energji elektrike të një kualiteti të caktuar me çmim të arsyeshëm, qartësisht të krahasueshëm, transparent dhe jo diskriminues”.

Neni 4 [Veprimtaritë në sektorin e energjisë elektrike]: “1. Veprimtaritë në sektorin e energjisë elektrike sipas këtij ligji janë: 1.5. furnizimi me energji elektrike; 1.6. furnizimi me shumicë i energjisë elektrike (tregtimi).”

Neni 5 [Kushtet për caktimin e obligimeve të shërbimit publik]: “3. Obligimet e shërbimit publik, të vendosura sipas këtij ligji, duhet të përkufizohen qartësisht, të jenë transparente, jodiskriminuese, të verifikueshme, si dhe duhet të garantojnë barazinë e qasjes për ndërmarrje të energjisë elektrike të konsumatorët vendorë. Për më tepër, vendosja e obligimeve të shërbimit publik si dhe zbatimi i tyre nga ndërmarrjet e energjisë duhet të bëhen në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese, duke mos penguar hapjen e tregut.”

Neni 22 [Tregu i energjisë elektrike]: “1. Tregu i energjisë elektrike përfshinë tregjet e energjisë elektrike me shumicë dhe pakicë.”

Neni 36 [E drejta për ndërrimin e furnizuesit]: “1. Çdo konsumator fundor, familjar ose jofamiljar, ka të drejtë të ndërrojë furnizuesin e tij.”

Neni 37 [Furnizimi me energji elektrike në kuadër të shërbimit universal]: “1. Për të siguruar ofrimin e furnizimit në kuadër të shërbimit universal, Rregullatori mund të ngarkojë me obligime të shërbimit publik cilindo furnizues sipas kriterëve dhe kushteve të përcaktuara me



nenin 5 të këtij Ligji, duke obliguar atë që të ofrojë furnizim me energji elektrike konsumatorëve që gëzojnë të drejtën e furnizimit në kuadër të shërbimit universal. Këto obligime duhet të vendosen në licencën e të ngarkuarit me obligime të shërbimit publik. 2. Të drejtën e furnizimit si shërbim universal e gëzojnë të gjithë konsumatorët familjar dhe jofamiljar që kanë qarkullim vjetor jo më shumë se dhjetë (10) milion euro, ose jo më shumë se pesëdhjetë (50) punonjës.”

Neni 39 [Furnizimi i garantuar]: “1. Furnizuesi i zgjedhur sipas nenit 40 të këtij ligji obligohet të furnizojë konsumatorët që ngelin pa furnizues në raste si në vijim: 1.1. furnizuesi i tij ka bankrotuar apo është në likuidim; 1.2. licenca e furnizuesit të mëparshëm është revokuar përkohësisht apo në mënyrë të përhershme, apo ka pushuar së vlejuri; 1.3. konsumatori ka dështuar në zgjedhjen e furnizuesit të ri pas ndërprerjes së kontratës me furnizuesin e mëparshëm.”

Neni 40 [Caktimi i furnizuesit të mundësisë së fundit]: “1. Në bazë të një procedure të hapur tenderimi, Rregullatori cakton furnizuesin e mundësisë së fundit jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. 2. Vendimi për hapjen e procedurës së tenderimit sipas paragrafit 1. të këtij neni përmban kriteret për zgjedhjen e furnizuesit të mundësisë së fundit, kushtet dhe afatet për furnizimin e garantuar, informatat për formimin e çmimit dhe ndryshimet e tij, kushtet dhe afatet e kontratës, si dhe kohëzgjatjen e periudhës për të cilën caktohet furnizuesi i mundësisë së fundit. 3. Furnizuesi i mundësisë së fundit caktohet për një periudhë veprimi si furnizues i tillë prej tre (3) vitesh. 4. Në rast se nuk zgjidhet furnizuesi i mundësisë së fundit në periudhën e përcaktuar me paragrafin 1. të këtij neni, Rregullatori do të caktojë një furnizues që përkohësisht të ushtrojë funksionin e furnizuesit të mundësisë së fundit, por jo më gjatë se gjashtë (6) muaj, periudhë kjo brenda të cilës do të zhvillohet tenderi i ri. Në rast se edhe tenderi i dytë dështon, Rregullatori cakton furnizuesin e mundësisë së fundit me një akt të veçantë, duke përcaktuar të gjitha kushtet dhe afatet për vendosjen e obligimit të shërbimit publik në pajtim me nenin 5 të këtij ligji.”

Neni 41 [Obligimet e furnizuesve të mundësisë së fundit]: “1. Përveç detyrimeve të furnizuesve tjerë, furnizuesi i mundësisë së fundit duhet të: 1.1.furnizojë konsumatorët fundorë sipas nenit 39 të këtij Ligji derisa konsumatorët të zgjedhin furnizuesin sipas dëshirës, por jo më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë; 1.2.faturojë konsumatorët fundorë të përcaktuar në nenin 39 të këtij ligji për energjinë elektrike të livruar, në pajtim me çmimet e furnizimit të garantuar, të miratuara nga Rregullatori në pajtim me metodologjinë e hartuar dhe miratuar nga Rregullatori; 1.3.informojë konsumatorët fundorë për kushtet e furnizimit të garantuar,



ndërprerjen e kontratës për furnizim të garantuar dhe të drejtën e tyre për zgjedhjen e lirë të furnizuesit të energjisë elektrike; 1.4.dorëzohë tek konsumatori fundor kontratën e furnizimit të garantuar jo më vonë se tetë (8) ditë nga fillimi i furnizimit.”

Udhëzuesi për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike, të datës 18.01.2017

Neni 8 [Derregullimi i çmimit për konsumatorët fundorë], “1. Derregullimi i çmimit të konsumatorëve fundorë do të bëhet në mënyrë graduale duke përdorur qasjen më të përshtatshme të mundshme me gjendjen aktuale dhe atë: 1.1. Konsumatorët industrial të kyçur në nivelin e Transmetimit 220kV, do t'i nënshtrohen kushteve dhe çmimeve të tregut për furnizim me energji elektrike më së largu deri më datën e lëshimit të këtij Udhëzuesi; 1.2. Konsumatorët industrial të kyçur në nivelin e Transmetimit 110kV, do t'i nënshtrohen kushteve dhe çmimeve të tregut për furnizim me energji elektrike më së largu deri më 31 mars të vitit 2017; 1.3. Konsumatorët komercial në nivelet e tension 35kV, 10kV do t'i nënshtrohen kushteve dhe çmimeve të tregut për furnizim me energji elektrike më së largu deri më 31 mars 2018; 1.4. Konsumatorët komercial në nivelet e tension 0.4kV do t'i nënshtrohen kushteve dhe çmimeve të tregut për furnizim me energji elektrike pas përpilimit të listës nga ana e ZRRE, e cila do të identifikoj konsumatorët të cilët nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj për furnizim me energji elektrike nga Shërbimi Universal. 1.5. Të gjithë konsumatorët fundorë do të kenë të drejtën që të furnizohen me energji elektrike në tregun konkurrues nga momenti i aprovimit të këtij udhëzuesi.”

Udhëzuesit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë, i ndryshuar dhe plotësuar më datë 13 qershor 2018, si dhe i ndryshuar dhe plotësuar më datë 30 tetor 2018, dhe i miratuar më datë 28 mars 2019

Neni 2 [Derregullimi i çmimit për konsumatorët fundor], “Neni 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 ndryshohet dhe plotësohet me tekstin në vijim: 1.3.1 Konsumatorët komercial në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët i nuk i plotësojnë kriteret sipas nenit 37, paragrafi 2 të Ligjit për Energjinë Elektrike, do t'i nënshtrohen kushteve dhe çmimeve të tregut për furnizim me energji elektrike më së largu deri më 31 mars 2020; 1.3.2 Konsumatorët komercial në nivelin e tensionit 10 kV, të cilët i nuk i plotësojnë kriteret sipas nenit 37, paragrafi 2 të Ligjit për Energjinë Elektrike, do t'i nënshtrohen kushteve dhe çmimeve të tregut për furnizim me energji elektrike më së largu deri më 31 mars 2021.”



IV. Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit nënligjor normativ të kontestuar

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi ka shqyrtuar me kujdes dispozitat ligjore të akteve nënligjore normative, të kontestuara nga paditësja, përkatësisht nenin 8 të Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike, të datës 18 janar 2017 si dhe nenin 2 të Udhëzuesit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë, i ndryshuar dhe plotësuar më datë 13 qershor 2018, si dhe më datë 30 tetor 2018, i miratuar më 28 mars 2019, ka vlerësuar se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.

Gjykata, kishte parasysh thelbin e pretendimeve të paditëses, e cila theksin kryesor të arsyeshmërisë së pretendimeve të saj e ka vendosur mbi: i) pretendimin se ZRRE ka tejkaluar kompetencat ligjore gjatë miratimit dhe zbatimit të Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike dhe akteve përcjellëse; ii) neni 8 i Udhëzuesit të vitit 2017 dhe neni 2 i Udhëzuesit të ndryshuar të vitit 2018/2019 janë në kundërshtim me nenin 37 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-085 për Energjinë Elektrike, pasi kanë interpretuar gabimisht kategoritë e konsumatorëve jo-familjarë; iii) Njoftimi Publik i ZRRE-së, i datës 12.03.2025 është akt real normativ, dhe ka shkaktuar pasoja financiare për bizneset; iv) veprimet e ZRRE-së dhe të KESCO-s kanë rezultuar me diskriminim ekonomik ndaj bizneseve të vogla dhe të mesme, si dhe me cenim të parimeve të barazisë, proporcionalitetit dhe sigurisë juridike të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet në fuqi.

Në anën tjetër, Gjykata mori parasysh edhe qëndrimin e palës së paditur: Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), e cila ripërsërit se: i) të gjitha aktet e kontestuara janë miratuar në përputhje me Ligjin Nr.05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin Nr.05/L-085 për Energjinë Elektrike, si dhe me obligimet ndërkombëtare të Kosovës që rrjedhin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë dhe Direktiva 2009/72/EC; ii) Udhëzuesi për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike (2017) kishte karakter orientues dhe tranzitor, jo normativ, dhe si i tillë ka përmbushur efektet e tij juridike deri më 31 mars 2021, prandaj nuk mund të kontestohet më (parimi *actus consumatus*); iii) Njoftimi publik i 12 marsit 2025 nuk paraqet akt administrativ individual apo normativ, por është njoftim informues për përfundimin e periudhës tranzitore të liberalizimit të tregut, i cili nuk prodhon efekte të drejtpërdrejta juridike ndaj palëve; iv) kriteret ligjore (10 milion € qarkullim ose (50 punëtorë) për të drejtën e furnizimit nga Shërbimi Universal nuk janë vendosur nga ZRRE, por nga ligji dhe Direktivat e BE-së; v) veprimet e ZRRE-së janë ndërmarrë në mënyrë transparente, të bazuar në



konsultime publike, dhe në interes të zhvillimit të tregut konkurrues të energjisë elektrike, siç kërkohej nga ligji dhe standardet evropiane.

Andaj, Gjykata Supreme e Kosovës, pasi shqyrtoj me kujdes pretendimet e parashtruara nga palët ndërgjyqëse, procedurën dhe veprimet e ndërmarra nga e paditura: Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), në drejtim të përmbushjes së detyrimeve ligjore për liberalizimin e tregut të energjisë përmes akteve të kontestuara nënligjore normative, vlerësoj se e paditura ka dështuar të ofroj pranë gjykatës dëshmi të mjaftueshme dhe bindëse se ka përmbushur në tërësi kriteret dhe ka ndjekur drejtë hapat për liberalizimin e tregut të energjisë, në kuptim të hapjes efektive të tregut, promovimit të konkurrencës efektive dhe zhvillimit të tregjeve konkurruese dhe funksionale.

Gjykata bazuar në provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, dhe pretendimet e elaboruara nga të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse, ka gjetur se:

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), është agjenci e pavarur e themeluar me Ligjin Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë me përgjegjësi për rregullimin ekonomik të sektorit të energjisë. Detyrat dhe funksionet e saj janë të përcaktuara më saktësisht në Ligjin Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, të cilat, ndër tjerash, përfshijnë: (i) krijimin dhe funksionimin efikas, transparent dhe jo diskriminues të tregut të energjisë; (ii) promovimin e tregut të brendshëm konkurrues të energjisë, duke siguruar hapje efektive të tregut për të gjithë konsumatorët dhe furnizuesit dhe krijim të kushteve të nevojshme për funksionim efektiv e të qëndrueshëm të rrjeteve të energjisë, duke i marrë parasysh objektivat afatgjata të sektorit, që kanë të bëjnë me autoritetet rregullative të sektorit të energjisë të Palëve Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë; (iii) zhvillimin e tregjeve konkurruese dhe funksionale brenda Kosovës, si pjesë e Komunitetit të Energjisë; (iv) sigurimin se konsumatorët përfitojnë nga funksionimi efikas i tregut kombëtar të tyre, nga promovimi i konkurrencës efektive dhe nga ofrimi i ndihmës për të siguruar mbrojtje të konsumatorëve.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit, me datë 18 Janar 2017 nxori Udhëzuesin për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë, me të cilën përcakton mënyrën, kushtet dhe kohën e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike në Kosovë, në nivelin e prodhimit dhe furnizimit me energji elektrike. Në nenin 8 par. 1 nënpar. 1.3 të këtij udhëzuesi ishte përcaktuar se: Derregullimi i çmimit të konsumatorëve fundorë do të bëhet në mënyrë graduale duke përdorur qasjen më të përshtatshme të mundshme me gjendjen aktuale dhe atë: Konsumatorët



komercial në nivelet e tensionit 35 kV, 10 kV do ti nënshtrohen kushteve dhe çmimeve të tregut për furnizim me energji elektrike më së largu deri më 31 mars 2018.

Me Udhëzuesin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë, të datës 13 qershor 2018, përkatësisht nenin 2 të tij, ndryshohet dhe plotësohet neni 8 par.1, nënpar.1.13, ashtu që përcaktohet: Konsumatorët komercial në nivelet e tension 35kV, 10kV do ti nënshtrohen kushteve dhe çmimeve të tregut për furnizim me energji elektrike më së largu deri më 31 mars 2019. I cili më pas ishte ndryshuar prapë me Udhëzuesin për Ndryshimin dhe Plotësimin, e datës 30 tetor 2018, ku përcaktohet se: Konsumatorët komercial në nivelet e tensionit 10kV do ti nënshtrohen kushteve dhe çmimeve të tregut për furnizim me energji elektrike më së largu deri më 31 mars 2020.

Udhëzuesi i datës 28 mars 2019, ka ndryshuar dhe plotësuar Udhëzuesit paraprak dhe neni 8 par. 1 nënpar.1.3 është ndryshuar dhe plotësuar siç vijon: 1.3.1 Konsumatorët komercial në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët i nuk i plotësojnë kriteret sipas nenit 37, paragrafi 2 të Ligjit për Energjinë Elektrike, do t'i nënshtrohen kushteve dhe çmimeve të tregut për furnizim me energji elektrike më së largu deri më 31 mars 2020; 1.3.2 Konsumatorët komercial në nivelin e tensionit 10 kV, të cilët i nuk i plotësojnë kriteret sipas nenit 37, paragrafi 2 të Ligjit për Energjinë Elektrike, do t'i nënshtrohen kushteve dhe çmimeve të tregut për furnizim me energji elektrike më së largu deri më 31 mars 2021.

E paditura me vendimin V_1925_2024, të datës 02 prill 2024 (pro.05.04.2024), i ka caktuar të licencuarit për Furnizim me Energji Elektrike "Kosovo Electricity Supply Company" J.S.C (KESCO), obligimin e shërbimit publik për furnizim me energji elektrike, për konsumatorët që gëzojnë këtë të drejtë, duke përcaktuar në pikën III, të tij se kujt i takon kjo e drejtë. Ndërsa me vendimin V_2762_2025, të datës 12 qershor 2025 (prot.07.07.2025), ka caktuar Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK) Sh.a, që të ushtrojë përkohësisht përgjegjësitë e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit (Furnizues i Garantuar). Furnizim ky i cili nuk mund të zgjasë më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë.

Në dritën e argumenteve të parashtruara dhe provave të administruara në shqyrtim gjyqësor të cilat gjenden në shkresat e lëndës, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se mospërputhjet ndërmjet dispozitave ligjore dhe dispozitave të lartcekura të akteve nënligjore normative kanë ndikuar në krijimin e një situatë të pasigurisë juridike dhe ekonomike për konsumatorët e energjisë elektrike, duke e bërë të domosdoshme ndërhyrjen e gjykatës për interpretim të



unifikuar të normave dhe për mbrojtjen e parimit të sigurisë juridike dhe të trajtimit të barabartë në tregun e energjisë elektrike.

Në këtë drejtim, mospërputhjet ndërmjet dispozitave të vetë legjislationit primar konsiderohet të jenë thelbësore për vendimmarrjen e kësaj gjykate. Kësisoj, neni 3 paragraf 1.72 i Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, përcakton se shërbimi universal është *“e drejta e konsumatorëve familjarë dhe ndërmarrjeve ekonomike që punësojnë jo më shumë se pesëdhjetë (50) punonjës dhe që kanë qarkullim vjetor jo më shumë se dhjetë (10) milion euro...”*. Ndërkaq, neni 37 paragrafi 2 i po këtij ligji përcakton se: *“të drejtën e furnizimit si shërbim universal e gëzojnë konsumatorët familjarë dhe jofamiljarë që kanë qarkullim vjetor jo më shumë se dhjetë (10) milion euro, ose jo më shumë se pesëdhjetë (50) punonjës”*. Ky ndryshim terminologjik, përdorimi i lidhëzës “ose” përkundrejt lidhëzës “dhe”, ka prodhuar paqartësi në zbatimin praktik të ligjit.

Po ashtu, neni 3 paragrafi 1.35 i Ligjit Nr. 05/L-081 për Energjinë e përkufizon shërbimin universal si: *“shërbim i detyrueshëm i furnizimit publik me energji elektrike për t’ua siguruar kategorive të caktuara të konsumatorëve të drejtën të furnizohen me energji elektrike të cilësisë së kërkuar, me tarifa të arsyeshme, transparente dhe jodiskriminuese”*. Ndërsa neni 20 paragrafi 2 i këtij ligji riafirmon se *“në pajtim me Ligjin për Energjinë Elektrike, disa kategori të konsumatorëve gëzojnë të drejtën e furnizimit universal dhe përfitojnë nga furnizimi i garantuar”*.

Gjykata kishte parasysh se, Kosova, që nga viti 2005 është palë nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, përmes të cilit ajo merr përsipër detyrimin për zbatimin e *“Acquis communautaire”* të Bashkimit Evropian në sektorin e energjisë elektrike, që detyron në mënyrë të veçantë zbatimin e Direktivave dhe Rregulloreve për Energji të Bashkimit Evropian. Për Kosovën, kjo do të thotë se institucionet shtetërore, janë të detyruara të harmonizojnë legjislationin energjetik dhe rregullues me detyrimet që dalin nga traktati, të cilat janë ligjërish të detyrueshme për Palët Kontraktuese.

Poashtu, kishte parasysh edhe Paketën e Tretë të Energjisë të Bashkimit Evropian (Third Energy Package), miratuar në 2009, ka për qëllim krijimin e një tregu të brendshëm të integruar, konkurrues dhe të sigurt të energjisë elektrike dhe gazit në BE dhe në vendet anëtare të Komunitetit të Energjisë, dhe ajo përfshin edhe direktivën për energjinë elektrike -



Direktiva 2009/72/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 13 korrik 2009 për Rregullat e Përbashkëta për Tregun e Brendshëm të Energjisë Elektrike, e cila është transpozuar pjesërisht në ligjin bazik për energjinë elektrike.

Andaj, me qëllim të interpretimit të drejtë dhe të saktë të nenit 37 par. 2, lidhur me nenin 3 paragraf 1.72 të Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, gjykata i'u referu përkufizimit të dhënë në këtë direktivë, përkatësisht nenit të 3 (3), i cili gjendet në Kapitullin II të Direktivës 2009/72/CE, dhe i cili trajton Rregullat e Përgjithshme për Organizimin e Sektorit, ku përcaktohet se: *“3. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë që të gjithë konsumatorët familjarë dhe, kur e shohin të përshtatshme, ndërmarrjet e vogla (ndërmarrje me më pak se 50 punonjës dhe një qarkullim vjetor ose bilanc jo më shumë se 10 milion EUR), të kenë shërbim universal, që do të thotë të drejtën për të furnizuar me energji elektrike me cilësi të caktuar brenda territorit të tyre, me çmime të arsyeshme, të lehta për t'u krahasuar, transparente dhe jo-diskriminuese. Për të siguruar shërbimin universal, Shtetet anëtare mund të caktojnë një furnizues të fundit”*. Në thelb, ky nen përcakton detyrimet e shteteve anëtare për të siguruar funksionimin e tregut të energjisë në përputhje me parimet e Direktivës, duke garantuar mbrojtjen e konsumatorëve dhe të drejtën e tyre për furnizim të sigurt dhe të barabartë, dhe gëzim të drejtës për shërbimin universal

Ky dallim thelbësor ndërmjet përdorimit të lidhëzës “dhe” në nenin 3 dhe “ose” në nenin 37, të Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, ndërlidhur me përkufizimin përkatës në nenin 3, nënparagrafi 1.35 dhe 20 të Ligjit Nr. 05/L-081 për Energjinë, tregon se vetë ligji bazik ka krijuar paqartësi për interpretim të saktë dhe të njëtrajtshëm të drejtës së shërbimit universal. Si rrjedhojë, shumë konsumatorë jofamiljarë nuk janë kategorizuar si konsumator që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike. Duke pasur parasysh se e paditura në zbatim të nenit 37 par.2 të Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, ka zbatuar dispozitën përcaktues me lidhëzën “ose”, gjykata vlerësoj se një zbatim i tillë është kundërtshëm me vetë dispozitat brenda për brenda ligjit.

Ndonëse, me aktvendimin e datës 26.08.2025, Gjykata kishte detyruar të paditurën që të dorëzoj dosjen e plotë administrative dhe të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me lëndën e çështjes, gjeti se e paditura gjykatës nuk i ka parashtruar si provë listën e identifikimit të konsumatorëve të cilët nuk plotësojnë kriteret e përcaktuar me ligj për furnizim me energji



elektrike nga shërbimi universal, (sipas nenit 37.par.2) dhe që si rrjedhojë pretendimet e saj në këtë drejtim i refuzoj në tërësi të paqëndrueshme dhe të pabazuara në fakte dhe në ligj.

Lidhur me pretendimet për përkufizimin jo të drejtë të konsumatorëve të energjisë elektrike, përkatësisht kategorizimin e tyre si “konsumatorë komercialë” dhe “industrialë”, me nivelizimin e tensionit dhe me ndërlidhjen e mos përmbushjes së kriterëve për të qenë përfitues i të drejtës së shërbimit universal sipas nenit 37 par.2 të Ligjit Nr.05/L - 085 për Energjinë Elektrike, gjykata vlerëson se këto kategorizime nuk janë në harmoni me përkufizimet dhe kategorizimet ligjore të përcaktuara në legjislacionin për energjinë, përkatësisht me përkufizimin e dhënë në nenin 3, par. 1 nënpar. 1.28 të Ligjit Nr. 05/L - 085 për Energjinë Elektrike, ku përcaktohet se: *“Konsumator jo familjar - person fizik a juridik që blen energji elektrike të cilën nuk e shfrytëzon për nevoja të veta familjare, e ku përfshihen edhe prodhuesit dhe blerësit me shumicë”*, ndërkohë që as ky kategorizim nuk është argumentuar pranë kësaj gjykate. Gjykata vëren se kategorizimi i konsumatorëve, ashtu siç është përcaktuar në dispozitat e akteve nënligjore normative, nuk është mbështetur me përkufizime apo sqarime qoftë sipas terminologjisë juridike apo ekonomike dhe si rrjedhojë ka shkaktuar konfuzion në praktikë për një numër të konsiderueshëm subjektsh ekonomike dhe gjykata vlerëson se çdo akt nënligjor normativ duhet të përmbaj terminologji të qartë dhe të kuptueshme për të gjitha ata që i dedikohet.

Referuar provës së parashtruar nga e paditura, përkatësisht Listës *“Licencat për Furnizim me Energji Elektrike në Kosovë të cilat mund të kryejnë edhe aktivitetin e Furnizimit me shumicë (tregtisë) së energjisë elektrike në Kosovë”*, gjykata gjeti se aktualisht janë gjithsej: 27 (njëzetë e shtatë) ndërmarrje të licencuara për furnizim me energji elektrike, dhe 1 (një) ndërmarrje në proces të licencimit. Gjykata gjeti, po ashtu se disa prej furnizuesve disponojnë me licencë të vlefshme vetëm deri në periudhën 2026 - 2027. Pavarësisht kësaj, nga shkresa nr.prot.2226, të datës 08.09.2025, lëshuar nga Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) Sh.A, gjykata gjeti se vetëm 6 gjashtë prej tyre janë ndërmarrje aktive në furnizim me energji elektrike, ndërsa me numër më të madh të pikave matëse janë: KESCO me gjithsej 4,641 pika matëse dhe KEK me gjithsej 3,955 pika matëse ndërsa konsumatorë pa furnizues gjithsej 351 pika matëse, që si rrjedhojë mund të konkludohet se nuk është përmbushur detyrimi i krijimit të kushteve për konkurrencë efektive në treg të hapur të energjisë dhe disa konsumator kanë mbetur pa furnizues.



Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund të pranojë të bazuar pretendimet e të paditurës kur thekson se: hapja e tregut është bërë në përputhje me parimet e konkurrencës së lirë dhe tregut të qëndrueshëm, ngase bazuar në vetë përgjigjen e ZRRE-së, pohohet se sipas të dhënave zyrtare nga KOSTT Sh.A, nr.2226, të datës 08.09.2025, dhe sipas gjendjes preliminare në treg operojnë 6 (gjashtë) furnizues aktivë me 9,508 (nëntë mijë e pesëqind e tetë) pika matëse, ndërsa 351 (treqind e pesëdhjetë e një) pika matëse që janë konsumator në procese të ndryshme të ndërrimit të furnizimit. Numër ky i cili për konsumatorët komercialë, siç i referohet e paditura, duket ende relativisht i vogël dhe jo mjaftueshëm konkurrues për të garantuar ofertë të favorshme për të gjithë konsumatorët.

Ndërlidhur me këtë, Gjykata vlerëson se në analizën e tregut energjetik, mjaftueshmëria e numrit të furnizuesve dhe pikave matëse nuk duhet të matet vetëm me shifra absolute, por me nivelin e konkurrencës efektive, që përfshin: numrin e furnizuesve që mund të ofrojnë kushte reale alternative, kapacitetin e tyre për të furnizuar pa ndërprerje, lirinë e konsumatorëve për të zgjedhur furnizuesin me çmim dhe kushte më të favorshme si dhe shtrirjen gjeografike dhe teknike të rrjetit për furnizim alternativ. Për më tepër, edhe procesi i ndërrimit të furnizuesit, nëse realisht ekziston do të duhej të jetë i thjeshtë, i lirë dhe i shpejtë për të gjithë konsumatorët. Nëse konsumatorët nuk kanë përfitime reale (çmime më të ulëta, shërbime më të mira), atëherë numri i furnizuesve nuk garanton konkurrencë efektive, pavarësisht se ligjërisht tregu është i hapur.

Gjykata kishte parasysh detyrimet ligjore për hapjen e tregut që burojnë nga Paketa e Tretë e Energjisë, megjithatë rikujton se për hapjen e tregut në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 15 të Ligjit nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, Rregullatori ka autoritetin dhe përgjegjësinë: për hapjen efektive të tregut, promovimin e tregut të brendshëm konkurrues të energjisë, mbrojtjen e konsumatorëve, zhvillimin e tregjeve konkurruese dhe funksionale brenda Kosovës, duke respektuar objektivat afatgjata të Komunitetit të Energjisë. Megjithatë, sipas provave të paraqitura, gjykata vëren se hapja e tregut nuk ka arritur të krijojë një konkurrencë efektive, pasi numri i furnizuesve aktivë është i vogël dhe shumica e konsumatorëve mbeten të varur nga dy kompani kryesore. Disa konsumatorë mbeten gjithashtu pa furnizues, duke treguar se e paditura nuk ka përmbushur plotësisht detyrimin për të krijuar kushtet e nevojshme për funksionimin efektiv të tregut.

Gjykata po ashtu vë theksin në detyrimin e të paditurës për mbrojtjen e konsumatorëve, në rastin e mungesës së konkurrencës efektive, e cila shpie deri në limitimin e ofertave dhe çmimeve konkurruese, mundësinë që disa konsumatorë të mbeten pa furnizues, qoftë edhe



përkohësisht, apo mund të krijojë varësi tek pak operatorë dominues dhe që si rrjedhojë pengon zhvillimin e tregut sipas standardeve të Komunitetit të Energjisë.

Lidhur me pretendimin e të paditurës për hedhjen poshtë të kërkesëpadisë së paditëses për shfuqizimin e Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuar më datë 18 janar 2017, me ndryshimet dhe plotësimet përkatëse, me arsyetimin se i njëjti ka pasur thjesht karakter tranzitor dhe orientues, është zbatuar plotësisht dhe ka shteruar efektet e tij juridike pas datës 31 mars 2021, pasi që sipas parimit të njohur në jurisprudencën administrative të “*efektit të konsumuar të aktit juridik*” (actus consumatus) nuk prodhon më pasoja juridike dhe nuk mund të jetë objekt shfuqizimi apo kontestimi gjyqësor, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se ky pretendim nuk është i bazuar.

Kolegji konstaton se, ndonëse Udhëzuesi i vitit 2017 formalisht është miratuar si akt orientues për fazat e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, dispozitat e tij, përfshirë nenin 8, kanë prodhuar efekte të drejtpërdrejta dhe të vazhdueshme juridike, pasi janë zbatuar në praktikë nga e paditura dhe nga furnizuesit e licencuar, duke ndikuar në pozitën juridike dhe ekonomike të një grupi të gjerë konsumatorësh jo-familjarë. Në këtë kuptim, përderisa aktet nënligjore dhe udhëzimet e mëvonshme të paditurës (përfshirë ato të viteve 2018, 2019) bazohen dhe referohen në Udhëzuesin fillestar të vitit 2017, i cili është shfuqizuar, është e qartë se ai vazhdon të ketë efekt juridik material dhe të prodhojë pasoja juridike.

Gjykata thekson se parimi i “*efektit të konsumuar*” (actus consumatus) nuk mund të interpretohet në mënyrë që të përjashtojë nga kontrolli gjyqësor aktet nënligjore që vazhdojnë të prodhojnë efekte faktike dhe juridike, për shkak se një interpretim i tillë do të cenonte të drejtën për mjet juridik efektiv, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Prandaj, Gjykata vlerëson se pretendimi i të paditurës për mos ekzistencë të objektit të padisë, me arsyetimin e shterimit të efekteve juridike të Udhëzuesit të vitit 2017, është i pabazuar në ligj dhe në fakt, për shkak se aktet e mëvonshme dhe veprimet konkrete të paditurës kanë riprodhuar vazhdimisht efektet e këtij akti.

Sa i përket pikës IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me të cilin hedhet poshtë si e palejueshme kërkesëpadia e paditëses me të cilën ka kërkuar shfuqizimin dhe shpalljen e paligjshmërisë së Aktit të Njoftimit Publik për Liberalizimin e Tregut të Energjisë në Kosovë, të paditurës ZRRE, të publikuar më datë 12.03.2025, si dhe detyrimin e të paditurës për udhëzimin e KESCO-së si furnizues i shërbimit universal për korrigjimin e faturave të muajit



qershor të shpërndara gjatë muajit korrik 2025, si dhe shfuqizimin e të gjitha kontratave individuale për konsumatorët jo-familjar pas datës 1 qershor 2025 deri në nxjerrjen e bazës së re ligjore dhe rregullatore, gjykata vlerësoj se:

Akti i kontestuar Njoftimi Publik për Liberalizimin e Tregut të Energjisë në Kosovë, i publikuar në ëeb faqen zyrtare të paditurës, më datë 12.03.2025, nuk është akt nënligjor normativ, në kuptim të nenit 3 par. 1, nënpar. 1.1 [Përkufizimet] të Ligjit Nr. 08/L-182 për Konfliktet Administrative, ku përcaktohet se: *“1.1. Akt nënligjor normativ - një akt, i nxjerrë në bazë të autorizimit të shprehur të një ligji të miratuar nga Kuvendi, që përcakton rregulla të detyrueshme sjellje në mënyrë abstrakte dhe të përgjithshme”,* dhe i njëjti nuk i nënshtrohet juridiksionit të Gjykatës Supreme, si gjykatë e shkallës së parë. Po ashtu, Gjykata Supreme, në kuptim të nenit 10 par.4 [Organizimi dhe Kompetenca] të këtij ligji, ku përcaktohet se: *“4. Gjykata Supreme, gjykon revizionin dhe si shkallë e parë dhe e vetme, padinë për shfuqizimin e një akti nën-ligjor normative”,* dhe nenit 70 [Vendimi në rastin e aprovimit të padisë për shfuqizimin e aktit nënligjor normativ] të tij ku përcaktohet se: *“1. Gjykata deklaron paligjshmërinë dhe shfuqizimin e plotë apo të pjesshëm të akti nënligjor normativ i cili është në kundërshtim me ligjin”,* vlerësoj se në procedurën për shqyrtimin e akteve nënligjore normative gjykata është e kufizuar në shqyrtimin e përputhshmërisë së aktit nënligjor të kontestuar me ligjin dhe nuk gjykon dhe vendos për kërkesat e tjera si ajo për detyrimin e korrigjimit të faturave apo shfuqizimit të kontratave individuale për konsumatorët jo-familjarë.

Në këtë drejtim, gjykata i refuzoj si të pathemelta të gjitha pretendimet e paditëses se akti i kontestuar është akt real normativ, me arsyetimin se i njëjti ka prodhuar efekte të menjëhershme juridike për subjektet ekonomike, dhe është publikuar në vegzën aktet në ëeb faqen e të paditurës, ngase i njëjti edhe po të përmbushte karakteristikat e një akti nënligjor normativ nuk ka kaluar përmes procesit të miratimit si një akt nënligjor normativ. Në këtë kontekst, Njoftimi Publik për Liberalizimin e Tregut të Energjisë në Kosovë, i publikuar më 12.03.2025, nuk është një akt nënligjor normativ, për shkak të natyrës së tij dhe përmbajtjes, dhe nuk i përmbush kërkesat e përcaktuara në nenin 3, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit nr. 08/L-182 për Konfliktet Administrative.

Në fund, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se mospërputhja e dispozitave kontestuese të udhëzuesve të ZRRE-së, e kombinuar me interpretimet e neneve 3 dhe 37 të Ligjit Nr.05/L-



084 për Energjinë Elektrike, në raport me Direktivën 2009/72/CE, ka rezultuar në një situatë juridike të paqëndrueshme, ku kufiri ndërmjet konsumatorëve që gëzojnë të drejtën e furnizimit universal dhe atyre që janë të detyruar të kalojnë në tregun e lirë nuk është përcaktuar në mënyrë të qartë e të parashikueshme.

Gjykata duke u mbështetur në vlerësimet e mësipërme, dhe pasi dispozitat e ligjit i interpretoj në favor të mbrojtjes së konsumatorëve dhe në frymën e direktivës së 2009/72/CE, e cila në formulimin e saj i referohet plotësisht të dy kriterëve në mënyrë kumulative, si dhe mos përmbushjes së detyrimeve për hapjen efektive të tregut, konstaton se dispozitat e kontestuara të udhëzuesve të lartcekur, nuk janë arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme dhe kanë prodhuar pasiguri juridike për konsumatorët, andaj të njëjtat shpallen të paligjshme dhe shfuqizohen.

V. Vlerësimi i gjykatës mbi kërkesat aksesore

Lidhur me shpenzimet e procedurës:

Sa i përket shpenzimeve të procedurës, Gjykata vendosi si në pikën V të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 463 të LPK-së, i cili parasheh “463.1 Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën. 463.2 Pala ka për detyrë që në kërkesën e saj në mënyrë të specifikuar t’i tregoj shpenzimet për të cilat kërkon shpërblim, duke parashtruar prova për shpenzimet e bëra, po që se nuk ekzistojnë provat e tilla në dosjen e lëndës. 463.3 Pala duhet ta paraqes kërkesën për pagimin e shpenzimeve më së voni deri në përfundimin e shqyrtimit që i paraprinë vendosjes mbi shpenzimet, e po që se është fjala për dhënien e vendimit pa u bërë shqyrtim paraprakisht, atëherë pala ka për detyrë që kërkesën për shpenzimet e procedurës ta parashtrojë në propozimin mbi të cilin gjykata duhet të vendosë. 463.4 Për kërkesën e palës për pagimin e shpenzimeve të procedurës, gjykata do të vendosë në aktgjykimin ose aktvendimin me të cilin përfundon procedura përpara kësaj gjykate. 463.5 Gjatë zhvillimit të procedurës gjykata vendosë me aktvendim të veçantë për pagimin e shpenzimeve të procedurës vetëm atëherë kur e drejta e shpërblimit nuk varet fare nga vendimi mbi çështjen kryesore”. Meqenëse paditësi nuk ka specifikuar shpenzimet e procedurës, dhe meqenëse sipas nenit 101 të LKA-së, administrata e paditur në çdo rast, detyrohet të bartë shpenzimet e veta, pavarësisht nga rezultati i procesit gjyqësor, gjykata vendosi që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale.



Lidhur me publikimin e aktgjykimit:

Gjykata vendosi në përputhje me nenin 70 paragrafi 2 të Ligjit nr. 08/L-18 për Konfliktet Administrativ. Në bazë të këtij neni, i cili përcakton se: *“Aktgjykimi i arsyetuar dhe pasi ka marrë formë të prerë, publikohet në të njëjtën mënyrë në të cilën është publikuar vetë akti, për efekt të hyrjes në fuqi.”* Bazuar në këtë dispozitë ligjore gjykata vendosi si në pikën V të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Publikimi i aktgjykimit kontribuon në transparencën e punës së gjykatës, në forcimin e parimit të sigurisë juridike, si dhe në udhëzimin e autoriteteve publike dhe qytetarëve lidhur me të drejtën dhe praktikën administrative. Duke pasur parasysh se Udhëzuesit nuk janë publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, gjykata vlerësoi se është e nevojshme që ky aktgjykim të bëhet i qasshëm për publikun, në mënyrën e njëjtë të publikimit të akteve nënligjore normative për efekt të hyrjes në fuqi, konform nenit 70 paragrafi 2 të LKA-së.

Duke u bazuar në të lartë cekurat, gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 10 paragraf 4, neni 11 paragrafi 3, neni 59, neni 70 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

P.A.nr.18/2025 të datës 05.11.2025

B. Profesionale

Zanë Buçinca

Kryetare e kolegjit

Delushe Halimi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi nuk është e lejuar ankesa.

(neni 10 paragraf 4 i LKA-së)



Republika e Kosovës
BAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETËN
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA – KOSOVA JUDICIAL COUNCIL
SEKRETARITATI – SEKRETARIJAT – SECRETARIAT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD

Shenja e kërkesës: **P.A.nr.18/2025**
Znak zahteva Ev. **D.H**

FLETËGËRGESE PËR DORËZIM PERSONAL
OTPREMNICA ZA LICNU DOSTAVU

Marrësi/Prima:

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), me seli në Prishtinë, Rr. "Bekim Fehmiu", ish ndërtesa e Fazitës, kati II

1. Pasi marrësi nuk u gjet në vendin e ku duhet të dorëzohej shkresa, pas lënies së lajmërimit me shkrim, dorëzimi u bë duke iu dhënë shkresat anëtarëve madhor të familjes së marrësit – kujdestarit të ndërtesës, fqut, personit që punon në të njëjtin vend të punës me marrësin.

1. Posto primilac nije zatecen na mestu gde se dostavljanje ime izvrsi-ti, dostava je data odraslom clanu domacinstva primaoca – nastonjiku.

2. Pasi marrësi ose pjesëtari i familjes së tij e ka refuzuara marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno clan njenog domcinstva odbio orijem, pismo je dostavljeno u stanu – radno mestu primaoca (pribiena na vratima stana odnosno prostorije gde je primilac zaposlje)

Më datë: ____/____/____ në ora ____:____
Dana U cas.

Shkaku i refuzimit _____
Rezlog adbijanja prijmea _____

Nënshkrimi i dorëzuesit – potpis dostavljaca

Titulli i shkresës që dorëzohet/Naslov pisma koja se dostavlja:

1) Aktgjykim i datës 05.11.2025.

Numri i shtojcave: 1
Broj priloga

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur më (me fjalë) / Povrdujemo prijem gorenavegong pisma (i slovima)

Nënshkrimi i marrësit – potpis primioca

Të panevojshme bjeri vizë - nepotrebn precrtali

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruaj dorëzuesi, duke shkruar shkronja pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet / Ako je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostaljac, nepomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.